

# MANUALI MBI QYTETARINË AKTIVE

“Youth and DemocraCity-  
Aktivizmi i të rinjve në shkollë,  
koha për një narrativë të re”



2020

Nga seritë e Edukimit Politik për të rinjtë/KRK/HSS Udhëzues/Doracak/3/2020

Kongresi Rinor Kombëtar është një organizatë ombrellë që ka si qëllim mobilizimin e organizatave rinore dhe fuqëzimin e rolit të të rinjve në shoqëri. Nëpërmjet Kongresit Rinor Kombëtar të rinjtë në të gjithë Shqipërinë kanë një zë të përbashkët për të adresuar, advokuar dhe lobuar për çështjet që prekin rininë.

Autorë:

**Dafina Peci**  
**Shila Parllaku**  
**Ili Gërdupi**  
**Eris Ibeokrshimi**

© 2020 nga

Kongresi Rinor Kombëtar

Address: Rr. Milto Tutulani, Nd. 6, Hyrja 8/ 3 & 4, 1019,

Tiranë – Shqipëri

[Info@krk.al](mailto:Info@krk.al)

Ky botim u realizua me mbështetjen e Fondacionit Gjerman Hanns Seidel  
Opinionet, gjetjet, përfundimet dhe rekomandimet e shprehura në këtë punim janë ato të autorëve dhe nuk pasqyrojnë domosdoshmërisht ato të Fondacionit Gjerman Hanns-Seidel.  
Asnjë pjesë e këtij publikimi nuk mund të riprodhohet në asnjë formë ose të përpunohet, shumëfishohet dhe shpërndahet duke përdorur sistemet elektronike, pa lejen me shkrim të Kongresit Rinor Kombëtar dhe Fondacionit Gjerman Hanns-Seidel, përveç rasteve kur një veprim i tillë është në përputhje me parashikimet ligjore në fuqi për të drejtat e autorit. Përdorimi komercial i këtij publikimi nuk është i lejuar.

## Tabela e përmbajtjes

### Kuadri Ligjor për Qeverinë e Nxënësve si një strukturë e rëndësishme në shkollë

|     |   |    |
|-----|---|----|
| 1.1 | Historiku i krijimit dhe funksionimit të strukturës së Qeverisë së Nxënësve ..... | 4  |
| 1.2 | Vështrim në Ligjin e Arsimit Parauniversitar .....                                | 6  |
| 1.3 | Rregullorja e brendshme e Qeverisë së Nxënësve .....                              | 7  |
| 1.4 | Parlamenti i Nxënësve të Shqipërisë.....  | 12 |

### Qeveria e Nxënësve – Roli, Funkcioni dhe Detyrat

|     |  |    |
|-----|--|----|
| 2.1 | Përkufizimi i strukturës së Qeverisë së Nxënësve .....                                     | 14 |
| 2.2 | Rëndësia e funksionimit të strukturës së Qeverisë së Nxënësve .....                        | 15 |
| 2.3 | Roli dhe struktura e Qeverisë së Nxënësve.....   | 17 |
| 2.4 | Kriteret për një Qeveri Nxënësish efektive.....  | 19 |
| 2.5 | Menaxhimi i financës së Qeverisë së Nxënësve .....   | 20 |
| 2.6 | Bashkëpunimi i Qeverisë së Nxënësve me struktura të tjera brenda dhe jashtë shkollës ..... | 21 |
| 2.7 | Fushatat dhe procesi i drejtë elektoral .....  | 23 |

### Qeveria e nxënësve dhe Shkolla Qendër Komunitare

|     |  |    |
|-----|--|----|
| 3.1 | Veçoritë dhe standartet e shkollës si qendër komunitare .....                              | 26 |
| 3.2 | Roli i Qeverisë së Nxënësve në shkollat e kthyer në qendra komunitare .....                | 32 |
| 3.3 | Aktivitetet dhe nismat e Qeverisë së Nxënësve në kuadër të Shkollës Qendër Komunitare..... | 36 |

|  |  |    |
|--|--|----|
|  | Praktika të mira nga vendet e rajonit dhe të Europës ..... | 37 |
|--|--|----|

# KUADRI LIGJOR PËR QEVERINË E NXËNËSVE SI NJË STRUKTURË E RËNDËSISHME NË SHKOLLË

## 1.1 Historiku i krijimit dhe funksionimit te struktures se Qeversise se Nxenesve



Qeveritë e nxënësve shpesh shërbejnë për të angazhuar studentët në mësimin e demokracisë dhe udhëheqjes. Një nga mendimtarët e parë që ka mbështetur krijimin e strukturave që imitojnë funksionet e qeverisë në shkolla dhe universitete ka qenë nga John Dewey në veprën e tij

Demokraci dhe Edukim të publikuar në vitin 1916.

Në Shtetet e Bashkuara të Amerikës, ku rëndësia e strukturave demokratike ka patur një rol thelbësor në funksionimin e shoqërisë, strukturat e studentëve kanë patur një rol të veçantë. Organizata e parë kombëtare në SHBA e udhëheqësve të qeverisë studentore, Federata Kombëtare e Studentëve (themeluar në 1925), mbështeti reformat e arsimit dhe kufizimet në sjelljen e studentëve. Gjatë viteve 1960, strukturat e studentëve u përfshinë masivisht në lëvizjen për të drejtat civile të cilat sollën shumë ndryshime në shoqërinë amerikane.

Pak dihet për ekzistencën e strukturave studentore të para luftës së dytë botërore në Shqipëri. Mbas vitit 1945, me shtimin e shkollave, dhe edukimin në masë të

popullsisë, lindën edhe strukturat e para të drejtimit të studentëve. Njësoj si në SHBA ku qeveritë e nxënësve zgjidhnin me votim të drejtpërdrejtë një president, sekretar dhe arkëtar, duke imituar strukturën qeverisëse ekzistuese, edhe në Shqipëri nxënësit ndiqnin modelin e qeverisë duke u inkuadruar brenda të ashtuquajturave organizata të masave.

Kryetari i një klase, i quajtur “komandant”, nuk zgjidhej me votime por emërohej nga mësuesja, dhe merrej e mirëqenë se klasajepite në mënyrë unanime mbështetjen e saj. Qeveria e nxënësve kishte emërtimin e Organizatës së Rinisë së Shkollës, dhe së bashku me organizatat e rinisë të strukturave të tjera formonin Organizatën e Rinisë, e cila ishte një nga organizatat pjesë e Partisë së Punës, e cila ishte partia e vetme deri në vitin 1990.

Me ndryshimin e sistemit qeverisës, edhe në Shqipëri u adoptua një sistem i ngjashëm me vendet e tjera. Përfaqësuesi i klasës në qeverinë e nxënësve zgjidhej me votim të fshehtë, dhe filloj të quhej senator, ndërsa drejtuesi i qeverisë së nxënësve ishte President i shkollës. Shkolla të ndryshme ndiqnin modele të ndryshme duke shtuar edhe role të tjera, si Kryeministër, Arkëtar etj., pa një uniformitet në struktura. Qeveria e nxënësve si strukturë në atë kohe i referohej ciklit 8-vjeçar dhe ciklit të mesëm.

Qeverinë e Nxënësve si strukturë e gjejmë në një nen të posaçëm për këtë strukturë në ligjin për sistemin arsimor parauniversitar. Funkzionimi dhe elementët e tjerë të punës së kësaj strukture detajohen me akte

nënligjore dhe udhëzime sa herë që është e nevojshme. Ligji dhe aktet nënligjore parashikojnë vetëm përdorimin e titujve Kryetar, Nënkryetar, Sekretar, dhe Anëtarë të qeverisë së nxënësve, por pavarësisht kësaj, titujt President dhe Senator vazhdojnë të jenë në përdorim të gjerë si nga nxënësit ashtu edhe nga mësuesit. Permendim ketu qe edhe ne kete

## 1.2 Vështrimi në Ligjin e Arsimit Parauniversitar



Ligjin nr. 69/2012 i datës 21.06.2012 “Për Sistemin Arsimor Parauniversitar në Republikën e Shqipërisë” parashikon në nenin 36, pika 1 se:

*“Qeveria e nxënësve është organizëm që mbron dhe promovon të drejtat e nxënësve dhe ndihmon në mbarëvajtjen e shkollës. Ajo ngrihet dhe funksionon sipas udhëzimit të ministrit”.*

Pra Qeveria e Nxenesve eshte nje strukutre qe sjell zerin e femijeve dhe te rinjve. Ajo krijohet dhe funksionon në përputhje me të gjitha udhëzimet e Ministritse së Arsimit

Sportit dhe Rinisë që kanë lidhje me të dhe me rregulloren e brendshme të shkollës.

Krijimi i Qeverisë së nxënësve është një strukturë që mbështet demokracinë dhe garanton për zbatimin e “Konventës për të drejtat e fëmijëve” dhe një sërë dokumentesh të tjera që kanë të bëjnë me lirinë dhe të drejtat e individit. “Konventa për të drejtat e fëmijëve” ratifikuar nga Qeveria Shqiptare u jep fëmijëve dhe të rinjve një sërë të drejtash ku ndërmjet të tjerash theksohet: “Fëmija ka të drejtë të thotë lirisht mendimin e tij në çështjet që lidhen me të.” (Neni 12)

Ligji për Arsimin parauniversitar dhe Dispozitat Normative, me anë të neneve të posaçme, mundësojnë krijimin e Qeverisë së nxënësve mbi bazën e nismës së lirë nga ana e tyre. Në këto dokumente përshkruhen edhe parimet e kriteret bazë të përgjithshme të funksionimit të Qeverisë së nxënësve.

Ligji parashikon parimet bazë mbi të cilat duhet mbështetur organizimi dhe funksionimi i qeverisë së nxënësve si zgjedhja e drejtpërdrejtë, mësuesi ndihmues dhe organizime të tjera të nxënësve, të ngritura për interesat e tyre shkencore, kulturore dhe sportive. Por ligji nuk mund të rregullojë çdo detaj dhe për këtë, Ministri i Arsimit ka nxjerr Udhëzimin nr. 25 date 02.08.2013 “Për Organizimin dhe Funksionimin e Qeverisë së Nxënësve”

#### ► Përbërja e qeverisë së nxënësve

Udhëzimi nr.25, datë.25.07.2018 “Për ngritjen dhe funksionimin e bordit të institucionit arsimor” parashikon qartë se në shkollat e arsimit bazë përfaqësohen në qeverinë e nxënësve klasat 6 - 9. Nxënësit në klasat 4-6 marrin pjesë në qeverinë e nxënësve vetëm nëse shkolla ofron vetëm arsim fillor.

Si rregull i përgjithshëm, çdo paralele e një klase ka një përfaqësues në qeverinë e nxënësve. Nëse një klasë ka më shumë se katër paralele, atëherë secila klasë zgjedh tre përfaqësues të cilët zgjedhin në total katër përfaqësues për qeverinë e nxënësve. Për ta bërë më të thjeshtë po japim shëmbullin e mëposhtëm:

*Klasa e 7 e shkollës X ka 5 klasa paralele. Kjo nuk lejon që secila paralele të ketë përfaqësuesin e saj në qeverinë e nxënësve, dhe për këtë arsye secila paralele do zgjedhë 3 përfaqësues të klasës. Në këtë shëmbull, 15 përfaqësuesit e klasës së 7, duhet të mblidhen së bashku dhe të zgjedhin mes tyre 4 përfaqësues të cilët do marrin pjesë në qeverinë e nxënësve.*

Ky mekanizëm është zgjedhur për të shmangur numrin tejet të lartë të anëtarëve në qeverinë e nxënësve, gjë e cila do të vështirësonte marrjen e vendimeve. Ky sistem garanton që në shkollat e arsimit bazë të mos ketë më shumë se 16 anëtarë në qeverinë e nxënësve, dhe në shkollat e arsimit të mesëm të mos ketë më shumë se 12 anëtarë.

► Kryetari

Kryetari i qeverisë së nxënësve, i cili zgjidhet midis anëtarëve të qeverisë së nxënësve, me votë të drejtpërdrejtë dhe të fshehtë të nxënësve të shkollës, ka këto funksione:

- a) drejton veprimtarinë e qeverisë së nxënësve;
- b) drejton ndarjen e detyrave ndërmjet anëtarëve të qeverisë së nxënësve;
- c) drejton hartimin dhe zbatimin e planit vjetor të qeverisë së nxënësve;
- d) është përfaqësuesi i nxënësve në bordin e shkollës;
- e) përfaqëson nxënësit e shkollës në veprimtari të ndryshme brenda dhe jashtë saj;

Në rast të thyerjes së rregullore së brendshme të shkollës dhe legjislacionit në fuqi shkarkohet nga detyra prej drejtorit të shkollës. Kryetari i qeverisë nuk duhet të ketë lidhje familjare me drejtorin e shkollës.

Në mbledhjen e parë zgjidhet gjithashtu edhe nënkryetari i qeverisë së nxënësve i cili kryen të njëjtat funksione me kryetarin në mungesë të tij.

► Sekretari

Sekretari i qeverisë së nxënësve, zgjidhet nga anëtarët e qeverisë së nxënësve në mbledhjen e parë.

- a) zgjidhet me shumicë votash në mbledhjen e parë të qeverisë së nxënësve;

b) përgatit materialet që do të shpërndahen në mbledhjet e qeverisë së nxënësve;

c) mban shënimet e mbledhjeve të qeverisë së nxënësve;

d) lajmëron anëtarët e qeverisë së nxënësve dhe të ftuarit për mbledhjen e radhës;

e) mban arkivin e qeverisë së nxënësve në një mjedis të institucionit.

► Anëtari

Anëtari i qeverisë së nxënësve:

a) komunikon mendimet e nxënësve që përfaqëson, në qeverinë e nxënësve;

b) përcjell vendimet e qeverisë së nxënësve te klasa që përfaqëson;

c) propozon nisma ose veprimtari, që mund të organizohen në nivel shkolle;

d) merr pjesë rregullisht dhe është aktiv në mbledhjet e qeverisë së nxënësve;

e) raporton në çdo mbledhje te kryetari i qeverisë së nxënësve.

► Mësuesi ndihmës

Qeveria e nxënësve në përmbushjen e detyrave të saj ndihmohet nga një mësues, i cili në bazë të nenit 36 (3) të ligjit, duhet të zgjidhet me votim të drejtpërdrejtë nga anëtarët e qeverisë së nxënësve.

Udhëzimi i ministrit përgjegjës për arsimin nuk shprehet mbi rolin e mësuesit ndihmës, duke lënë vetëm parashikimin e ligjit. Nënkuptohej se mësuesi ndihmës duhet të japë pëlqimin e tij për të marrë rolin mbasi

të jetë zgjedhur nga qeveria e nxënësve. Roli i mësuesit ndihmës është të ndihmojë qeverinë e nxënësve të marri vendimet e duhura duke i këshilluar për tema të ndryshme.

Në varësi të rregullores së qeverisë së nxënësve të secilës shkollë, roli i mësuesit ndihmës mund të jetë proaktiv, që jep kontribut vet, ose reaktiv, që kontribuon vetëm për ato çështje për të cilat i kërkohet ndihmë.

### 1.3 Rregullorja e qeverisë së nxënësve



Udhëzimi nr.25, datë.25.07.2018 “Për ngritjen dhe funksionimin e bordit të institucionit arsimor” parashikon dy Rregullore të ndryshme të cilat lehtësojnë mbarëvajtjen e shkollës, rregulloren e shkollës dhe rregulloren e qeverisë së nxënësve. Ndërsa për Rregulloren e shkollës ka një model tip të miratuar nga Ministria e Arsimit përmes Udhëzimit nr. 30 date 02.08.2013, për rregulloren e qeverisë së nxënësve e cila merr rëndësi në këtë nënkapitull nuk ka një model të ofruar.

Qeveria e nxënësve ka detyrimin të ketë një rregullore të sajën e cila do hartohet nga grupe nxënësish, dhe miratohet nga qeveria e nxënësve pasi është marrë pëlqimi nga bordi dhe drejtori i shkollës. Kjo nënkupton se secila shkollë do ketë një rregullore të ndryshme dhe të veçantë, nëse nuk zgjedh të marri modelin e një shkolle tjetër.

Aktet ligjore në fuqi nuk japin tregues mbi përmbajtjen e rregullores së qeverisë së nxënësve, duke u lejuar shkollave lirshmëri në përzgjedhjen e normave që do zbatojnë. Nga ana tjetër, mungesa e udhëzimeve të qarta krijon mundësinë e problemeve që mund të lindin nga mungesa e elementëve që janë të nevojshëm për Rregulloren. Qëllimi i Rregullores është lehtësimi i mbledhjeve të qeverisë së nxënësve duke shmangur konfliktet dhe shpërdorimin e kohës, ndërkohë që i jepet një mundësi e barabartë të gjithëve për tu shprehur.

Mungesa e një elementi të domosdoshëm në Rregullore, prsh. mos parashikimi i rradhës së fjalës gjatë një diskutimi, do donte të fliste i pari. Dhënia e një zgjidhje të momentit shpesh kërkon kohë dhe nuk siguron afatgjatësi në zbatimin e rregullave. Gjithashtu, një zgjidhje e momentit mund të linte të pakënaqur anëtarin i cili do prekej nga rregulli i sapovendosur.

Në mungesë të udhëzimeve të qarta mbi përmbajtjen e Rregullores, ky manual do përpiqet të japi disa tregues të cilët duhet të jenë qeveritë e shkollave përkatëse që do i zgjedhin. Rregullorja e qeverisë së



nxënësve duhet të përmbajë në veçanti rregulla mbi temat e mëposhtme:

#### I. Kryetari i Qeverisë së Nxënësve - zgjedhjet, kompetencat

Kryetari i qeverisë së nxënësve zgjidhet domosdoshmërisht në mënyrë të drejtpërdrejtë nga të gjithë nxënësit e një shkolle. Rregullorja mund të parashikojë kompetencat e tij gjatë duke shtuar, ose qartësuar ato të dhëna nga Udhëzimi i Ministrisë të Arsimit si drejtimi i veprimtarisë e qeverisë së nxënësve, ndarjes së detyrave ndërmjet anëtarëve të qeverisë së nxënësve, dhe hartimin dhe zbatimin e planit vjetor të qeverisë së nxënësve.

#### II. Sekretari i qeverisë së nxënësve - zgjedhjet, kompetencat

Ndryshe nga Kryetari, Sekretari zgjidhet me votim nga anëtarët e zgjedhur të qeverisë së nxënësve në mbledhjen e saj të parë, së bashku me Nënkryetarin. Sekretari përgatit materialet që do të shpërndahen në mbledhje, mban shënimet e mbledhjeve, lajmëron anëtarët e qeverisë së nxënësve dhe të ftuarit për mbledhjen e radhës, si dhe mban arkivin e qeverisë së nxënësve në një mjedis të institucionit.

#### III. Pozicionet e lira

Rregullorja duhet të përcaktojë se si do veprohen nëse një nga pozicionet mbetet i lirë. Kjo mund të ndodhi nëse një anëtar i qeverisë së nxënësve jep dorëheqjen, ndërron shkollë, ose shkarkohet për shkak

të sjelljes. Opsionet që mund të zgjidhen variojnë mes kalimit të mandatit automatikisht tek kandidati i radhës me më shumë vota, ose organizimi i zgjedhjeve të reja për atë pozicion. Rregullorja mund të parashikojë edhe një zgjedhje të ndërmjetme ku për pozicionet e votuar drejtpërdrejtë nga nxënësit (anëtarët, kryetari) të kalojë mandati tek kandidati i radhës, dhe për anëtarët e zgjedhur nga qeveria e nxënësve të bëhet rivotim për shkak se nuk kërkon të njëjtin angazhim për tu organizuar.

#### IV. Grupet në qeverinë e nxënësve - Llojet e komisioneve, kompetencat, mënyrat e zgjedhjes

Rregullorja duhet të parashikojë grupet ose komisionet kryesore në qeverinë e nxënësve, si dhe mënyra e zgjedhjes. Shembuj të këtyre grupeve mund të jenë grupi i aktiviteteve, grupi i gazetës së shkollës, grupi bashkpunimit me organizata, dhe grupe të tjera që janë specifike për secilën shkollë. Pjesëmarrja në grupe nuk duhet të jetë e kufizuar tek anëtarët e qeverisë së nxënësve, por mund të jetë e hapur për të gjithë nxënësit në varësi të interesave dhe aftësive.

#### V. Thirrja e mbledhjeve të zakonshme

Mbledhjet e qeverisë së nxënësve thirren nga Sekretari, i cili ka për detyrim të njoftojë të gjithë anëtarët. Rregullorja mund të përcaktojë se në cilat ditë dhe orare mund të mbahen zgjedhjet, si dhe mund të

vendosi për një shpeshësi midis mbledhjesh. Në rast se ka çështje të ngutshme për tu diskutuar, mbledhja mund të njoftohet edhe duke mos respektuar afatet, por anëtarët duhet të dakordësohen se çfarë përbën çështje të ngutshme.

Rregullorja mund të përcaktojë edhe një kuorum që duhet të arrihet në mënyrë që mbledhjet të konsiderohen të vlefshme. Kuorumi mund të fillojë nga gjysma e anëtarëve deri në kërkimin e një pjesëmarrje të plotë. Sa më i lartë kuorumi aq më të mëdha janë mundësitë që mbledhje të mund të dështojnë për shkak se jo të gjithë anëtarët kanë mundur të marrin pjesë.

#### VI. Organizimi i mbledhjeve të zakonshme

Drejtimi i mbledhjeve bëhet nga kryetari i qeverisë së nxënësve, dhe në mungesë të tij nga nënkryetari. Mbledhja fillon duke verifikuar nëse kuorumi i pjesëmarrësve është arritur, dhe duke bërë me dije rendin e ditës.

Rregullorja duhet të përcaktojë nëse votimet për çështje të caktuara do bëhen të hapura apo të mbyllura, duke respektuar parimet e demokracisë. Shënimet e mbledhjeve të qeverisë së nxënësve të mbajtura nga sekretari, u shpërndahen anëtarëve brenda një afati të përcaktuar nga rregullorja.

VII. Pjesëmarrja dhe e drejta për të folur  
Kryetari i qeverisë së nxënësve ka një votë të barabartë me atë të anëtarëve të tjerë të qeverisë për çështjet e diskutuara. Rregullorja duhet të përcaktojë nëse do lejohen të tjerë pjesëmarrës në mbledhjen e qeverisë së nxënësve përveç anëtarëve dhe mësuesit ndihmës, si dhe nëse këta të ftuar do kenë mundësi të flasin, apo vetëm mund të dëgjojnë gjatë mbledhjes.

Nëse rregullorja do lejojë pjesëmarrjen e të ftuarve në mbledhje, ajo duhet të përcaktojë edhe mënyrën se si do bëhet ftesa.

#### VIII. Zgjedhja dhe roli i mësuesit ndihmës

Mësuesi ndihmës është një rol shumë i rëndësishëm pjesë e funksionimit të qeverisë së nxënësve. Ligji përcakton që ky mësues duhet të zgjidhet nga vetë anëtarët e qeverisë së nxënësve, por kjo kërkon që mësuesi i zgjedhur të japë pëlqimin e tij që pranon pozicionin e ofruar.

Megjithesë mësuesi ndihmës nuk voton në mbledhje, kontributi i tij në lidhje me organizimet në shkollë është shumë i vyer që mbledhjet e qeverisë së nxënësve të mos dalë jashtë pritshmërive reale. Në të njëjtën kohë rregullorja duhet të përcaktojë edhe limite për mësuesin ndihmës, i cili nuk mund të marrë kontrollin e mbledhjeve të qeverisë së nxënësve, dhe ta kthejë strukturën në jo-funksionale

#### IX. Masat disiplinore

Në çdo grup ekziston mundësia e konflikteve dhe e shkeljes së rregullave të rëna dakord. Për këtë shkak, Rregullorja duhet të parashikojë edhe masa për shkelësit e rregullave, në mënyrë që të sigurohet respektimi i tyre nga të gjithë.

Masat disiplinore në Rregulloren e qeverisë së nxënësve duhet të jenë në përputhje me shkeljen. Rregullorja duhet të përcaktojë edhe procedurën që duhet ndjekur për dhënien e masave. Ato mund të variojnë nga dhënia e një vrejtheje, në përjashtimi si anëtarë i qeverisë së nxënësve. Është e rëndësishme që të kuptohet që masa e përjashtimit nuk mund të jepet nga një njeri i vetëm, por duhet të jetë si rezultat i një votimi të cilësuar, për shkaqe të përligjura.

Anëtari i cili kërkohet të shkarkohet i jepen të gjitha mundësitë për tu mbrojtur dhe për të argumentuar se përse ai nuk duhet të shkarkohet.

#### X. Të ndryshme

Cdo institucion arsimor ka veçoritë e tij që e bëjnë të ndryshëm nga të tjerët. Është e këshillueshme të mendoni gjatë hartimit të rregullores së shkollës tuaj edhe për rrethana të tjera me të cilat mund të përballet qeveria e nxënësve gjatë punës së sajë.

## 1.4 Parlamenti i Nxënësve të Shqipërisë



“Parlamenti i Nxënësve” të Shqipërisë do të shërbejë si një organ këshillimor pranë ministrisë përgjegjëse për arsimin, në fokus të punës të të cilit do të jetë zhvillimi dhe thellimi i çdo lloji politike që synon drejtpërdrejtë përmirësimin e cilësisë së jetës së të rinjve në vend, rritjen e pjesëmarrjes së tyre në jetën publike, si dhe angazhimin e shtuar të tyre në vendimmarrje.

Parlamenti i Nxënësve të Shqipërisë është një strukturë e krijuar rishtazi përmes Udhëzimit nr. 22 të datës 04.10.2019 të Ministrit të Arsimit, Sporteve dhe Rinisë, dhe nuk është e parashikuar në ligjin për arsimin parauniversitar. Parlamenti i nxënësve kërkon të bëjë bashkë nxënës nga të gjitha qytetet e Shqipërisë në një strukturë të vetme. Parlamenti i nxënësve do ketë një numër të njëjtë me numrin e deputetëve të Kuvendit të Shqipërisë, pra 140 përfaqësues, të cilët do zgjidhen një herë në dy vjetë.

Në mënyrë që anëtarët e zgjedhur të kenë një mandat të plotë përfaqësimi, nxënësit e klasave të nënta, dhe nxënësit e klasave të dymbëdhjeta nuk mund të kandidojnë për

Parlamentin e Nxënësve të Shqipërisë. Kjo bëhet për tu siguruar se mandati i anëtarit të zgjedhur nuk do ti ndërpritet mandati gjatë vitin e dytë me përfundimin e shkollës.

#### ► Mënyra e zgjedhjes anëtarëve e Parlamentit të Nxënësve

Anëtarët e Parlamentit të nxënësve duhen zgjedhur me votim të drejtpërdrejtë nga të gjithë nxënësit që ndjekin arsimin parauniversitar në Shqipëri. Kandidatët për Parlamentin e Nxënësve nga një shkollë, është kryetari i qeverisë së nxënësve. Kandidati konkurren me kryetarët e shkollave të tjera të qeverisë së nxënësve për të plotësuar kuotat e caktuara për secilin rreth. Kuotat përcaktohen në mënyrë proporcionale me numrin e shkollave që ka secili rreth, duke bërë që rrethet që kanë një numër më të madh shkollash të kenë edhe një numër më të lartë përfaqësuesish në Parlamentin e Nxënësve

Zgjedhjet organizohen një herë në dy vjet, ku mandati i anëtarëve përfundon vetëm mbasi zgjidhen kandidatët e rinj. Si rregull zgjedhjet organizohen në fillim të vitit shkollor, mbasi të jenë përfunduar zgjedhjet për qeverinë e nxënësve të secilës shkollë. Për shkak se ky është një proces i sapo filluar, rregullat e qarta janë subjekt i ndryshimeve të herë pas hershme.

Procesi zgjedhor organizohet nga ministria përgjegjëse për arsimin, e cila garanton

votimet, dhe shpall fituesit mbas numërimit të votimit. Zgjedhjet e para u organizuan në muajin Tetor të vitit 2019, dhe pritet që zgjedhjet e ardhshme të organizohen përgjatë vitit 2021. Kuotat e caktuara për Parlamentin e Nxënësve ishin të veçanta për shkollat 9-vjeçare nga ato të mesme, duke i dhënë mundësi edhe nxënësve të klasave më të ulta për tu zgjedhur.

Duke marrë parasysh që zgjedhjet e zhvilluara ishin të parat, dhe ka një hapësirë të konsiderueshme kohe midis dy zgjedhjesh, nuk përjashtohet mundësia që procedura të ndryshohet.

#### ► Funkcionimi i Parlamentit të Nxënësve

Në seancën e parë mbas shpalljes së fituesve, zgjidhen kryetari dhe zëvendëskryetarët e Parlamentit të Nxënësve, anëtarët e Sekretariatit Teknik.

Ndërkohë anëtarët e tjerë të parlamentit Parlamentit ndahen në komisionet parlamentare në mënyrë që të marrin një përjetim sa më të mirë të eksperiencës parlamentare. Parlamenti i nxënësve duhet të hartojë një rregullore dhe vendosi për datën e takimit të ardhshëm.

Anëtarët e Parlamentit të Nxënësve mblidhen tre herë në vit për të diskutuar çështjet e rëndësishme për ta, si dhe për iniciuar aktivitete në nivel kombëtar.

## QEVERIA E NXENESVE ROLI FUNKSIONET DHE DETYRAT

### 2.1 Përkufizimi i strukturës së Qeverisë së Nxënësve

Sipas udhëzimit nr.25 datë 02.08.2013 "Për organizimin dhe funksionimin e qeverisë së nxënësve" Qeveria e nxënësve është organizëm që ngrihet me nismën e nxënësve të shkollës.

Qeveria e nxënësve është një organizëm i ngritur në çdo shkollë dhe ka për mision:

- a) të mbrojë dhe të promovojë të drejtat e nxënësve;
- b) të kontribuojë në plotësimin dhe zhvillimin e interesave të nxënësve;
- c) të ndihmojë në mbarëvajtjen e shkollës;
- d) të përfaqësojë nxënësit e shkollës në marrëdhëniet me drejtorinë e shkollës,

komunitetin dhe nxënësit e shkollave të tjera.

Qeveria e nxënësve është një grup nxënësish të një shkolle, të zgjedhur me votim nganxënësit e asaj shkolle për t'i përfaqësuar ata dhe pikëpamjet e tyre. Qeveria e nxënësve është një formë organizimi e nxënësve për ushtrimin e të drejtës dhe përgjegjësi të tyre pjesëmarrëse në vendimmarrje të rëndësishme të shkollës dhe jashtë saj



## 2.2 Rëndësia e qeverisë së nxënësve në vendimmarrje



Qeveria e nxënësve si një strukturë e pavarur do të ndihmojë të çojë në rritjen e iniciativës dhe vetëveprimit tuaj, në rritjen e mendimit të lirë dhe krijues, në forcimin e personalitetit tuaj, në aftësimin tuaj për të marrë përsipër përgjegjësitë si dhe në krijimin e një mentaliteti dhe një psikologjie të re për pozicionin dhe rolin e nxënësve në shkollë, për tju bërë partnerë dhe pjesëmarrës aktive në proceset e ndryshimeve demokratike në shkollë dhe në komunitet duke ju bërë qytetarë të denjë të një shoqërie të emancipuar.

### Rëndësia e Qeverisë së Nxënësve

Krijimi dhe funksionimi me efikasitet i Qeverisë së nxënësve ndikon pozitivisht në jetën e shkollës sepse:

- ▶ krijohet një partneritet i strukturuar me nxënës, drejtues, mësues, prindër në dobi të mirës së përbashkët. Realizimi i objektivave të shkollës është i suksesshëm kur ato kuptohen qartë dhe pranohen nga të gjithë partnerët brenda komunitetit të shkollës;
- ▶ informohen edhe nxënësit për ecurinë e punës së shkollës

- ▶ nxënësit mund të tregojnë që janë të aftë të japin një kontribut të vlefshëm për të rritur cilësinë e shkollës së tyre
- ▶ nxënësve u jepet mundësia të dëgjohen nga të gjithë partnerët e shkollës, për të paraqitur shqetësime, ide dhe sugjerime që kanë të bëjnë me mirëqenien e tyre dhe mbarëvajtjen e shkollës
- ▶ sigurohet pjesëmarrja e të rinjve nëpërmjet një rruge konkrete. Qeveria e nxënësve është si një laborator në të cilin nxënësit mund të nxënë dhe të praktikojnë shprehitë e qytetarisë, respektin për dinjitetin njerëzor dhe zbatimin e proceseve demokratike
- ▶ nxënësve u rritet personaliteti, u forcohet ndjenja e iniciativës dhe sipërmarrjes të cilat janë të nevojshme për individin e shoqërisë së sotme
- ▶ nxënësve u jepet mundësia të fitojnë dhe të zhvillojnë më tej shprehitë të komunikimit, punës në grup, planifikimit, bashkërendimit, organizimit dhe drejtimit të cilat do t'u vlejnjë edhe për të ardhmen
- ▶ sigurohet një burim i vlefshëm informacioni për drejtuesit e shkollës dhe drejtues të tjerë të arsimit jashtë shkollës, mësuesit dhe nxënësit e tjerë të shkollës për çështje që i preokupojnë të gjithë
- ▶ krijohet atmosferë pozitive në shkollë

Shumë fëmijë mund të ëndërrojnë të bëhen presidentë, dhe qeveria e nxënësve mund të jetë hapi i parë drejt kësaj ëndrre. Duke u bashkuar me qeverinë e nxënësve, nxënësit

do të mësojnë gjithçka rreth procesit të zgjedhjeve. Jo vetëm mbi krijimin e sloganeve, materialeve zgjedhore dhe shkrimit të fjalimeve, por do të kuptojnë se cilat janë qëndrimet e tyre për çështje të rëndësishme në shkollën dhe komunitetin jetojnë. Në qeverinë e nxënësve, fitohet përvojë në punën në grupe dhe dokumente profesionale. Mësojnë të shikojnë përtej detyrave të shtëpisë apo provimeve dhe se si aftësitë që merren mund të zbatohen në botën reale.

Pjesëmarrja në qeverinë e nxënësve mund të jetë një përvojë pasuruese me ndikime të qëndrueshme pozitive, që listohen si më poshtë:

#### Njohja me strukturat qeveritare

Qeveria e nxënësve i prezanton nxënësit me strukturën dhe funksionin e përgjithshëm të qeverisë dhe proceset e saj.

#### Ndërtimi i marrëdhënieve

Të punosh ngushtë me nxënës të tjerë dhe shkollë u jep mundësinë nxënësve për të ndërtuar miqësi të forta, domethënëse dhe marrëdhënie profesionale.

#### Përmirësoni shkollën

Ata që përfshihen në qeverinë e nxënësve mund të propozojnë nisma, politika, shtrirje dhe aktivitete të tjera që mund të krijojnë ndryshime pozitive brenda shkollës dhe komunitetit të tyre.

#### Fitoni aftësi profesionale

Shkathtësitë profesionale si komunikimi efektiv, hulumtimi, prezantimi i ideve,

organizimi i takimeve dhe eventeve dhe bashkëpunimi midis grupeve të ndryshme, të gjitha mund të zhvillohen dhe vlerësohen përmes qeverisë së nxënësve. Do të mësoni më shumë për veten tuaj dhe si të bashkëveproni me njerëzit. Jo vetëm që do të përmirësoni aftësitë e komunikimit dhe punës në grup, por do të filloni të kuptoni cilat janë qëndrimet e rëndësishme për ju.

#### Forconi CV-në tuaj/ resumenë

Për shkak të aftësive dhe njohurive të fituara dhe angazhimit të kërkuar, të kesh qenë pjesë e qeverisë së nxënësve në një rezyme mund të jetë një avantazh kur të aplikoni për universitet, punë dhe praktikë/intership.

#### Gjeni dhe zhvilloni interesa personale

Nëse nxënësit e dinë se janë të interesuar në zhvillimin e politikave ose nëse ata kanë vështirësi në realizimin e një pasioni apo interesi, përfshirja në qeverinë e nxënësve ofron shumë mundësi për të zhvilluar interesat e tyre.

#### Mësoni më shumë për veten tuaj

Ndonjëherë në shkollë të mesme nxënësit e dini se kush janë dhe ndonjëherë jo. Të qenurit pjesë e qeverisë së nxënësve mund ti ndihmojë nxënësit të shohin të ardhmen e tyre. Jo vetëm që do të mësojnë për etikën e punës dhe mënyrën e bashkëveprimit me të tjerët, por mund të gjejnë aspekte të vetes që nuk e kanë ditur se i posedonin.

### Mësoni të punoni në grup

Puna efektive në grup është një aftësi e paçmuar që nxënësit me siguri do ta praktikojnë gjatë qeverisjes së nxënësve.

### Network-u

Anëtarët e qeverisë së nxënësve krijojnë lidhje stafin e shkollës, aktivistët lokal dhe politikë-bërësit, anëtarët e komunitetit dhe njerëzit e tjerë me interes dhe ndikim. Ky ekspozim mund të hapë shumë dyer për nxënësit në të ardhmen.

## 2.3 Roli dhe Stuktura e qeverisë së nxënësve



Sipas legjislacionit shqiptar, në udhëzimin Nr. 25, datë 2.8.2013 për organizamin dhe funksionimin e qeverisë së nxënësve, struktura e qeverisë së nxënësve për arsimin e mesëm të lartë së bashku me detyrat përkatëse është përcaktuar si më poshtë:

1. Kryetari i qeverisë së nxënësve, i cili zgjidhet midis anëtarëve të qeverisë së nxënësve, me votë të drejtpërdrejtë dhe të fshehtë të nxënësve të shkollës, ka për detyrë:

- drejton veprimtarinë e qeverisë së nxënësve;
- drejton ndarjen e detyrave ndërmjet anëtarëve të qeverisë së nxënësve;
- drejton hartimin dhe zbatimin e planit vjetor të qeverisë së nxënësve;
- është përfaqësuesi i nxënësve në bordin e shkollës;
- përfaqëson nxënësit e shkollës në veprimtari të ndryshme brenda dhe jashtë saj;
- shkarkohet nga detyra prej drejtorit të shkollës në rast të thyerjes së rregullores së brendshme të shkollës dhe legjislacionit në fuqi.

2. Sekretari i qeverisë së nxënësve, zgjidhet nga anëtarët e qeverisë së nxënësve në mbledhjen e parë.

- zgjidhet me shumicë votash në mbledhjen e parë të qeverisë së nxënësve;
- përgatit materialet që do të shpërndahen në mbledhjet e qeverisë së nxënësve;
- mban shënimet e mbledhjeve të qeverisë së nxënësve;
- lajmëron anëtarët e qeverisë së nxënësve dhe të ftuarit për mbledhjen e radhës;
- mban arkivin e qeverisë së nxënësve në një mjedis të institucionit.



3. Anëtari i qeverisë së nxënësve, zgjidhet nën kujdesin e mësuesve kujdestarë përkatës, ku për çdo klasë paralele zgjidhet nga një anëtar i qeverisë së nxënësve.

- a) komunikon mendimet e nxënësve që përfaqëson, në qeverinë e nxënësve;
- b) përcjell vendimet e qeverisë së nxënësve te klasa që përfaqëson;
- c) propozon nisma ose veprimtari, që mund të organizohen në nivel shkolle;
- d) merr pjesë rregullisht dhe është aktiv në mbledhjet e qeverisë së nxënësve;
- e) raporton në çdo mbledhje te kryetari i qeverisë së nxënësve.

Roli kryesor i qeverisë së nxënësve është të promovojë interesat e shkollës dhe përfshirjen e nxënësve në punët e shkollës, në bashkëpunim me nxënësit, prindërit dhe mësuesit. Qeveria e nxënësve përcjell zërin e nxënësve në strukturat e shkollës dhe nëse është e nevojshme edhe jashtë saj për plotësimin e interesave të komunitetit të nxënësve për mbrojtjen e të drejtave të tyre dhe për një arsimim sa më cilësor. Funkcionet dhe aktivitetet e qeverisë së nxënësve duhet të mbështesin qëllimet dhe objektivat e qeverisë dhe të promovojnë zhvillimin e shkollës dhe mirëqenien e nxënësve të saj. Në planifikimin dhe ndërmarrjen e aktiviteteve gjatë vitit shkolle,

**Qeveria e nxënësve duhet:**

1. të punojë ngushtë me menaxhimin e shkollës, mësuesit dhe prindërit,

2. të konsultohen rregullisht me nxënësit në shkollë, dhe
3. të përfshijë sa më shumë nxënës në aktivitetet e qeverisë.
4. të mundësojë komunikimin midis nxënësve, mësuesve dhe prindërve
5. të promovojë një mjedis të favorshëm për zhvillimin arsimor dhe personal
6. të promovojë miqësi dhe respekt midis nxënësve
7. të përfaqësojë pikëpamjet e studentëve për çështje me interes të përgjithshëm për ta

**Roli i Qeverisë së nxënësve**

Shkolla është një mini-shoqëri që ka rregullat, normat dhe vlerat e saj. Shkolla modelon një mënyrë të jetuari dhe të vepruari dhe është si një arenë në të cilën përvojat që merren zgjasin për gjithë jetën. Një nga synimet e arsimit është të përgatisë njerëz që të jenë qytetarë aktivë dhe të mirinformuar për komunitetet në të cilat jetojnë; të kuptojnë ndryshimin dhe të bëhen pjesë e ndryshimit. Një nga risitë e shkollës për këtë qëllim është edhe Qeveria e nxënësve, e cila duke qenë një nga format e demokracisë në veprim, luan rol parësor në edukimin e vlerave e qëndrimeve demokratike dhe i ndihmon nxënësit të kuptojnë dhe të binden se edhe ata mund të jenë aktorë të ndryshimit, në shkollë, në komunitet dhe më gjerë në shoqëri.

Qeveria e nxënësve është e suksesshme në rolin e saj nëse:

- ▶ dëgjon pikëpamjet, sugjerimet e idetë e të gjithë nxënësve të shkollës
- ▶ mbron të drejtat e nxënësve përfaqëson pikëpamjet e nxënësve duke u kthyer në një forum ku të gjithë nxënësit mund të adresohen për çështjet me interes të përgjithshëm për ta
- ▶ është partnere ose lehtësuese në punën për arritjen e objektivave të shkollës
- ▶ sensibilizon dhe këshillon masën e nxënësve për zbatimin e politikave të reja në shkollë
- ▶ është nismëtare dhe nxitëse e ideve në të mirë të shkollës, të vetë nxënësve dhe të komunitetit më të gjerë informon drejtuesit e shkollës lidhur me shqetësimet e nxënësve për të cilat ata nuk janë në dijeni dhe për zgjidhjet që propozon
- ▶ vendos ura komunikimi ndërmjet nxënësve nga njëra anë dhe mësuesve, drejtuesve, prindërve e komunitetit nga ana tjetër (Qeveria e nxënësve jo vetëm informon drejtuesit e shkollës për shqetësimet dhe propozimet e nxënësve, por edhe nxënësit për qëndrimin dhe reagimin e drejtuesve të shkollës)
- ▶ ndihmon në formën e patronazhit, nxënës me probleme (personale, sociale etj)
- ▶ motivon krijimin e një klime pozitive në shkollë duke ndihmuar në zgjidhjen e konflikteve dhe organizimin e veprimtarive me tematika interesante e gjithëpërfshirëse
- ▶ bashkëpunon me komunitetin e gjerë

- ▶ ndikon në përmirësimin e marrëdhënieve nxënës–nxënës duke nxitur miqësinë dhe respektin midis tyre
- ▶ ndikon në përmirësimin e marrëdhënieve mësues- nxënës
- ▶ Ndikon në përmirësimin e kushteve të mjedisit mësimor dhe mjedisit fizik të shkollës

## 2.4 Kriteret për një qeveri nxënësish efektive



Një qeveri e mirë nxënësish posedon fuqi, autoritet dhe përgjegjësi.

- ▶ Është zëri përfaqësues i nxënësve.
- Qeveria është organizata e nxënësve që do të thotë se ai është i vendosur në qendër të nxënësve dhe në dobi të tyre.
- ▶ Propozon dhe kryen veprimtari për përmirësimin e shkollës.
- Një përmirësim i tillë mund të sugjerohet nga nxënësit, administrata ose komuniteti.
- ▶ Bashkërendon aktivitetet shtesë të kurrikulës së shkollës, duke përfshirë të gjithë personelin e shkollës në këtë mënyrë.

### Lidershipi

- Vendosni një shembull pozitiv për t'u ndjekur nga të tjerët.
- Zhvilloni dhe zgjeroni njohuritë dhe aftësitë e lidershipit për veten tuaj dhe të tjerët.
- Eksploroni dhe praktikoni parimet demokratike dhe qytetarinë.

### Shërbim

- Krijoni një frymë vullnetarizmi për kujdesin ndaj njëri tjetrit.
- Shërbejini të tjerëve në shkollë dhe komunitet.
- Zgjeroni pikat e forta akademike.

### Zëri

- Bëhuni zëri i nxënësve.
- Jepini secilit nxënës mundësinë që të dëgjohet.
- Ndani idetë, shqetësimet dhe zgjidhjet përmes komunikimeve pozitive.

### Angazhim

- Promovimi i aktiviteteve dhe ngjarjeve të suksesshme dhe gjithëpërfshirëse.
- Bëni që çdo nxënës të ndjehet i mirëpritur dhe të jetë pjesë e jetës shkollore.
- Nxitni një kulturë të sigurtë dhe ftuese për të gjithë nxënësit.

Në vitin 1999, Eugene Ratsoy dhe Bing Zuo publikuan një studim për Qeverinë Studentore në një revistë kanadeze, që u përqëndrua në "qëllimin, procesin dhe efektet e pjesëmarrjes së studentëve në qeverisjen e universitetit". Ata përcaktuan

disa faktorë të lidhur me arsyen pse studentët zgjodhën të marrin pjesë në aktivitetet e qeverisë studentore, përfshirë dëshirën e studentëve për të marrë pjesë në kontrollin institucional, rritjen personale, fitimi i përvojës dhe aftësive shoqërore, dhe dëshirën për t'u shërbyer studentëve të tyre. Botuar në vitin 2008, ata zbuluan se disa nga karakteristikat e grupit qeverisës së studentëve ishin që ata kanë një kuptim të qartë të qëllimit të tyre, mundësojnë kanalizimin e kontributit të studentëve për funksionimin institucional, dhe dëshira për të përfshirë një larmi të çështjeve shqetësuese të tyre. Një qeverisje efektive studentore përfshin kryerjen e një dialogu të strukturuar, zotërimin e burimeve të nevojshme për të përmbushur qëllimet e tyre dhe përshkrimin e qartë të detyrave të pjesëtarëve të qeverisë studentore. Nëpërmjet kombinimit të këtyre karakteristikave dhe elementeve, grupet qeverisëse efektive e dinë se kush janë dhe për çfarë shërbejnë, kanë aftësinë për të kryer angazhime përmes drejtuesve të qeverisë së nxënësve me burime të mjaftueshme dhe avokim për të ndikuar në vendimmarrjen institucionale.

## 2.5 Menaxhimi i financës së Qeverisë së Nxënësve

Menaxhimi i financave sa i takon qeverisë së nxënësve është një çështje delikate e cila aktualisht nuk është e rregulluar në mënyrë të qartë.

Qeveria e nxënësve ka të drejtën e organizimit të aktiviteteve të ndryshme të cilat kanë nevojë për para dhe mjete. Duke marrë shembullin e gazetës së shkollës, e cila botohet nga qeveria e nxënësve, mungesa e fondeve do pengonte shtypjen e saj. Edhe nëse kostot e shtypjes do tejkalohehin, është gjithmonë paqartësia se si do veprohej me paratë e mbledhura nga shitja e gazetave.

Në situatën aktuale, qeveria e nxënësve nuk ka asnjë mundësi për të disponuar financa, dhe kjo deri diku është e arsyeshme duke marrë parasysh moshën e re të anëtarëve të saj. Kjo nuk nënkupton që qeveria e nxënësve nuk mund të ketë njëfarë kontrolli mbi paratë që duhen për aktivitetet e saj, si dhe paratë që mund të gjenerohen prej saj. Janë të këshillueshme dy zgjidhje për menaxhimin financiar, menaxhimi nga stafi i shkollës, menaxhimi nga një OJF



#### ► Menaxhimi nga stafi i shkollës

Institucionet arsimore kanë të drejtën e pasjes së një llogarie në bankat e nivelit të dytë, gjë që u jep mundësi atyre të menaxhojnë lirisht edhe para të cilat nuk vijnë nga thesari i shtetit. Menaxhimi i llogarive bankare të institucionit arsimor bëhet nga drejtori i shkollës, duke krijuar kështu mundësinë që qeveria e nxënësve

përmes kryetarit të saj, të mund të kontaktojnë me drejtorin sa herë që lind nevoja për kryerje shpenzimesh. Një alternative nga kryetari do mund të ishte edhe mësuesi ndihmës i cili është gjithnjë prezent gjatë mbledhjeve të qeverisë së nxënësve dhe në dijeni të situates.

Kjo zgjidhje kufizon qeverinë e nxënësve duke i rritur rolin drejtorit të institucionit, por ama është një zgjidhje tejet e sigurtë, dhe që i lejon qeverisë së nxënësve të mund të menaxhojë fonde dhe të krijojë të ardhura. Në këtë zgjidhje kërkohet një bashkëpunim sa më i plotë midis qeverisë së nxënësve dhe drejtorit të shkollës.

#### ► Menaxhimi nga OJF

Udhëzimi i Ministrisë të Arsimit ka parashikuar në veprimtaritë e qeverisë së nxënësve përgatitjen dhe realizimin e projekteve, pasi të jetë marrë më parë miratimi i drejtorit të shkollës, me organizata jofitimprurëse, të cilat kanë në fokusin e tyre të drejtat e fëmijëve, pjesëmarrjen e fëmijëve dhe të rinjve në vendimmarrje dhe arsim. Këto projekte i japin lirshmëri qeverisë së nxënësve të mund të financojnë veprimtarinë e tyre në kuadrin e projektit të një organizate jofitimprurëse.

Organizatata jofitimprurëse kanë një menaxhim të pavarur financiar, i cili lejon krijimin e hapësirave për gjenerim fondesh përmes veprimtarive ekonomike dhe donacioneve, duke krijuar mundësinë për mbështetjen administrative ndaj qeverive të

nxënësve. Kjo zgjidhje kërkon gjithësesi miratimin e drejtorit të shkollës, i cili duhet të jap pëlqimin për çdo projekt të ndërmarrë, por ky miratim mjafton të jepet një herë për secilën organizatë.

Në mënyrë që zgjidhja të funksionojë kërkoet gjithashtu një bashkëpunim i hapur midis qeverisë së nxënësve në fjalë dhe organizatës jo-fitimprurëse nga e cila është kërkuar suporti. Numri i madh i organizatave mundëson që secila qeveri nxënësish të ketë lirshmërinë të zgjedhë se më cilën organizatë do ndihej më mirë të punonte

## 2.6 Bashkëpunimi i Qeverisë së Nxënësve me struktura të tjera brenda dhe jashtë shkollës



Qeverisë së nxënësve duhet tu ofrojë të të gjithë të interesuarve mundësi për bashkëpunim dhe komunikim efektiv brenda shkollës.

### Qeveria e nxënësve dhe nxënësit e shkollës

Sa më të përfshirë të jenë nxënësit e shkollës në punën dhe aktivitetet e qeverisë së nxënësve aq më tepër rezultate positive do të ketë.

Nxënësit e shkollës komunikojnë me qeverinë e tyre në mënyrë informale, nëpërmjet bisedave të lira, por ato duhet të planifikojë edhe mënyra të tjera formale për t'u informuar për interesat, dëshirat, dhe problemet e nxënësve të shkollës për shembull:

1. të caktojë një orare për takime me nxënësit
2. të zhvillojë biseda të organizuara me nxënës të një klase edhe thjesht për të informuar për punën e kryer
3. të kryejë anketime apo intervista për një temë të caktuar
4. të qarkullojë planin mujor të veprimtarive për të marrë reagime nga nxënësit

### Qeveria e nxënësve dhe Drejtori i shkollës

Në detyrat e Drejtorit të shkollës të përcaktuara me ligjin Nr. 69/2012 "Për sistemin arsimor para-universitar në Republikën e Shqipërisë" vihet re qartë që Drejtori i shkollës është vendosur në qendër të gjitha veprimtarive të shkollës. Ai ka një rol të rëndësishëm jo vetëm në themelimin e qeverisë së nxënësve por edhe në funksionimin e saj. Drejtori i shkollës ka si përgjegjësi që qeveria e nxënësve të veprojë brenda legjislacionit dhe të jetë sa më eficiente. Roli i tij është të jetë bashkëpunues dhe udhërrëfyes i vazhdueshëm. Gjithashtu ai duhet të jetë monitorues i procesit të formimit dhe funksionimit për të siguruar që formimi dhe veprimtaria e Qeverisë së nxënësve nuk bien ndesh me legjislacionin dhe rregulloren e shkollës.

### Qeveria e nxënësve dhe mësuesi ndihmues

Roli i mësuesit ndihmues në mbarëvajtjen e qeverisë së nxënësve është shumë i rëndësishëm. Këtë rol mund ta kryejë një nga mësuesit e shkollës i cili caktohet të punojë pranë Qeverisë së nxënësve për të ndihmuar dhe këshilluar kryesisht në tri drejtime:

1. në hartimin dhe zbatimin e planit të veprimtarive, përfshirë edhe menaxhimin e fondeve
2. në funksionimin sa më të mirë të lidhjeve të Qeverisë së nxënësve me hallkat e tjera të shkollës
3. në nxitjen e interesave dhe ideve

Mësuesi ndihmues zgjidhet me konsensus ndërmjet kryetarit të qeverisë së nxënësve dhe Drejtorit të shkollës.

Disa nga detyrat e mësuesit ndihmues janë:

1. ndihmon në sigurimin dhe forcimin e rolit të Qeverisë së nxënësve në shkollë
2. ndjek mbledhjet e Qeverisë së nxënësve dhe këshillon, jep informacion dhe moderon situatën të caktuara nëse kjo gjë i kërkohet
3. kujdeset që qeveria e nxënësve të veprojë brenda kompetencave të saj
4. inkurajon mësuesit dhe anëtarë e qeverisë së nxënësve të ftojnë njëri tjetrin në mbledhjet e tyre
5. mundëson që qeveria e nxënësve të bëhet pjesë aktive e jetës së shkollës
6. ndjek me vëmendje ecurinë e punës së qeverisë së nxënësve

7. kujdeset që të gjithë anëtarëve të qeverisë së nxënësve tu jepet rasti për të shprehur pikëpamjet e tyre
8. mësuesi ndihmues mund të luajë rolin e ndërmjetësit kur ka mosmarrëveshje

## 2.7 Fushatat dhe procesi i drejtë elektorale



Garimi për të qenë pjesë e qeverisë së nxënësve është një nga vendimet më të mira që mund të merrni si nxënës për të lënë shenjë dhe për të dhënë kontributin tuaj. Para së gjithash më e rëndësishmja është vendosja e qëllimeve dhe objektivat tuaja kryesore përpara fushatës. Pse nxënësit duhet të votojnë për ty? Çfarë mund të ofroni dhe si mund të sillni një ndryshim pozitiv?

### ► Bisedoni me shokët tuaj të klasës

Përpara se të futeni në ritmin e garës duhet të përcaktoni disa elementë të veçantë që ju dallojnë nga garuesit e tjerë dhe të vendosni prioritetet për të strukturuar fushatën tuaj elektorale. Dilni, njihni dhe bisedoni me shokët e shkollës. Diskutoni me ta ndryshimet dhe përmirësimet që ata

do të donin të shihnin më shumë në shkollën e tyre. Duke qenë aktivë që nga fillimi i fushatës suaj, kjo do t'ju ndihmojë të fitoni besimin dhe respektin e shokëve tuaj të klasës e të shkollës. Por mbi të gjitha do t'ju ndihmojë në objektivat ku mund të përqëndroni fushatën tuaj. Një metodë e shkëlqyeshme për të bërë një kërkim më të detajuar rreth ndryshimeve, përmirësimeve apo problematikave në shkollë, është të krijoni një sondazh nëpër platforma të ndryshme të mediave sociale si Facebook, Instagram apo Tëitter. Pyesni shokët tuaj të klasës se çfarë ndryshimesh favorizojnë më shumë, cilat janë problematikat që i shqetësojnë dhe nëse mund të sugjerojnë përmirësime apo avancime për tu kryer në shkollë. Në këtë mënyrë, të gjithë nxënësit kanë mundësinë për të shprehur mendimin e tyre.

#### ► Krijoni një Logo

Tërhiqni vëmendjen e shokëve tuaj të klasës me një logo argëtuese dhe krijuese. Një logo është një nga mënyrat më të mira për t'u përfaqësuar në një fushatë, është një mënyrë të qartë për të prezantuar veten tuaj. Logoja siguron një themel për fushatën tuaj pasi do të përfshihet gjatë gjithë strategjisë suaj. Duke qenë se ajo do të jetë në posterat e fushatës, fletushka, bluza etj, sigurohuni që logoja juaj të jetë e veçantë dhe e dallueshme. Përzgjidhni një model tërheqës, luani me tekstin, zgjidhni një stil fonti dhe ngjyra të gjalla, sepse logoja do të diktojë jo vetëm energjinë por do të transmetojë vizionin e fushatës tuaj.

#### ► Krijoni një slogan të paharrueshëm

Sloganet luajnë një rol të rëndësishëm në çdo lloj fushate. Ato ndihmojnë në promovimin e kauzës tuaj dhe në rritjen e angazhimit. Një slogan tregon se për çfarë bëhët fjalë fushata juaj në një mënyrë të qartë dhe koncize. Ai përfaqëson fushatën tuaj. Një nga aspektet kryesor për t'u marrë parasysh kur krijoni një slogan është të siguroheni që do të jetë i paharrueshëm. Në këtë fazë keni diskutuar folur me shokët tuaj të klasës për çështjet që për ta kanë rëndësi. Keni vendosur objektivat tuaj bazë të fushatës dhe keni krijuar logon tuaj. Atëherë, çfarë po pret? Krijoni një slogan të paharrueshëm që do të forcojë këto objektiva. Nuk duhet të jetë e gjatë. Slogani duhet të jetë i shkurtër dhe energjik për të rrëmbyer vëmendjen e audiencës suaj.

#### ► Dizenjoni postera për fushatën

Krijoni postera që tërheqin vëmendjen duke përdorur logon dhe sloganin tuaj. Përforconi politikatat që keni ndërmend të zbatoni nëse fitoni zgjedhjet. Në posterat që do të krijoni, do të ishte mirë të vendosni një imazh/fotografi të vetes tuaj për tu bërë më i dallueshëm. Varni posterat në çdo cep të shkollës. Në korridoret e shkollës, fushat e sportit, menca, palestra, këto elementë e bëjnë fushatën tuaj të pagabueshme. Kjo do t'i inkurajojë njerëzit të votojnë për ju.

#### ► Krijoni fletushka

Mendoni që fletushkat janë një gjë e së kaluarës? Mendohu perseri. Fletushkat kanë qenë gjithmonë një komponent

kryesor në çdo fushatë marketingu. Ato janë akoma një mënyrë e shpejtë dhe e thjeshtë për të përhapur mesazhin tuaj. Merrni vëmendjen e shokëve tuaj të klasës duke krijuar fletushka për zgjedhjet. Mos i mbingarkoni fletushkat me informacione të gjata, sigurohuni që të përfshini detajet më të rëndësishme në lidhje me fushatën tuaj. Vendosni logon dhe sloganin tuaj, imazhin tuaj dhe dizenjoheni me ngjyrat e fushatës suaj.

#### ► Postime në media sociale

Shfrytëzoni fuqinë e mediave sociale dhe gjithçka që ka për të ofruar. Duke qenë se rrjetet sociale janë vendi ku nxënësit kalojnë pjesën më të madhe të kohës, shfrytëzimi i rrjeteve sociale është mënyra më e mirë për t'u prezantuar nxënësve të shkollës se po kandidoni për qeverinë e nxënësve. Krijimi i postimeve tërheqëse për mediat sociale në platforma si Facebook, Tëitter dhe Instagram janë një mënyrë e mirë për të përhapur lajmet, për të fituar njohje, për të informuar njerëzit për qëllimet tuaja dhe për çdo ngjarje të zgjedhjeve që keni planifikuar. Postimet në mediat sociale duhet të jenë vizualisht tërheqëse, të qarta dhe koncize. Është e rëndësishme që të komunikohet mesazhi dhe qëllimet tuaja thelbësore. Një tjetër ide, do të ishte krijimi i një faqeje në Facebook apo në rrjete të ndryshme sociale për të rritur vizibilitetin e fushatës tuaj.

#### ► Xhironi një video promovuese

Krijoni një video promovuese që do të rrisë vëmendjen e audiencës tuaj. Ju duhet të

përfitonit plotësisht nga teknologjia dhe ta bëni veten të njohur në çdo platformë të mediave sociale. Një video promovuese do t'ju ofrojë një kanal tjetër komunikimi për t'ju prezantuar nxënësve se kush jeni dhe për çfarë po garoni. Videoja duhet të jetë e shkurtër; mundësisht një deri në dy minuta. Sigurohuni që videoja juaj të jetë me cilësi të lartë dhe me ndriçim të mirë. Shmangni gabimet e zakonshme siç janë, tingulli i dobët, ndriçimi i keq etj. Jini transparent duke theksuar qëllimet dhe objektivat kryesorë të fushatës suaj. Sigurohuni që të demonstroi qartë se cilat janë qëllimet tuaja dhe si do të ndikoni në qeverinë e nxënësve.

#### ► Shkruani një fjalim të mirë për garimin në qeverinë e nxënësve

Shkrimi i një fjalimi për garimin në qeverinë e nxënësve mund të duket frikësuese në fillim. Në mbarim të fjalimit tuaj, do të jetë hera e fundit që njerëzit do të dëgjojnë nga ju përpara se të marrin vendimin e tyre dhe të votojnë. Ky fjalim shënon fundin e fushatës suaj. Fjalimi juaj është një nga komponentët më të rëndësishëm për të cilin duhet të punoni, sepse duhet të jetë jashtëzakonisht bindës.

Kur të përgatitni fjalimin tuaj të qeverisë së nxënësve sigurohuni që:

1. Prezantoni veten - Mos filloni fjalimin tuaj thjesht duke u thënë të gjithëve se cili është emri juaj. Hapni fjalimin me një pyetje ose një fakt.
2. Merrni vëmendjen e audiencës tuaj.
3. Tregoni kualifikimet dhe përvojën tuaj.



4. Listoni arsyet pse po kandidoni për qeverinë e nxënësve.
5. Përcaktoni qëllimet dhe objektivat tuaja.
6. Shpjegoni ndryshimet që do të bëni dhe si do t'i zbatoni këto ndryshime.
7. Shpjegoni se si do të përfitojnë bashkëmoshatarët tuaj nëse përzgjidheni në qeverinë e nxënësve.
8. Kërkoni të votojnë për ju.
9. Thoni fjalët përmbyllëse.
10. Faleminderoni të gjithë për ndihmën dhe mbështetjen e tyre gjatë gjithë fushatës së zgjedhjeve.
11. Përfundoni fjalimin me sloganin tuaj.

Në mënyrë që zgjedhjet e qeverisë së nxënësve të edukojnë vërtet nxënësit mbi funksionimin e demokracisë, është e rëndësishme që para së gjithash, të përcaktohen rolet dhe përgjegjësitë e qeverisë së nxënësve. Qeveria e Nxënësve duhet të bazohet në Legjislacionin Shqiptar dhe rregullat dhe rregulloret e çdo shkolle.

Detyra që duhen mbajtur parasysh për ditën e zgjedhjeve:


- Hartimi dhe verifikimi i listave të zgjedhësve nga regjistrimet zyrtare.
- Identifikimi i secilit votues në vendin e votimit.
- Regjistroni emrat e votuesve për të parandaluar votimin e personave të paautorizuar ose votimin për herë të dytë.
- Numëroni fletëvotimet e vlefshme dhe përgatitni raportet zyrtare për rezultatet e zgjedhjeve.





## QEVERIA E NXENESVE DHE SHKOLLA QENDER KOMUNITARE

### 3.1 Veçoritë dhe standartet e SHQK



Edukimi cilësor është arsimi që punon dhe i mundëson të gjithë fëmijëve dhe të rinjve të arrijnë potencialin e tyre të plotë. Shkolla komunitare është një iniciativë e cila është më afër përmbushjes për një edukim cilësor për çdo fëmijë. Shkolla si qendër komunitare është një nismë e ndërmarrë nga Ministria e Arsimit dhe Sportit në vitin 2013 dhe aktualisht në vendin tonë janë pjesë e kësaj nisme 270 shkolla nga të cilat 91 shkolla të arsimit të mesëm të lartë.

Iniciativa e SHQK u hartua si një strategji inovative për shërbime të integruara në

lidhje me komunitetin. Kjo nismë synon përmirësimin e cilësisë së punës dhe jetës në shkollë si dhe është një mundësi për kultivimin e vlerave demokratike, sigurimin e mirëqenies sociale, emocionale, shëndetësore të nxënësve, angazhimin dhe zhvillimin e komunitetit, si një mundësi për vendimmarrje të përbashkëta, respektimin e shumëllojshmërisë dhe përdorimin e burimeve komunitare në shërbim të shkollës. Kjo nismë e kthen shkollën në vendin ku ndërtohet partneriteti shkollë-familje-komunitet dhe bashkëpunohet për zhvillimin e kapaciteteve dhe potencialit të plotë çdo nxënësi.

Koncepti i SHQK, mbështetet në Konventën për të Drejtat e Fëmijës dhe paraqet një qasje gjithëpërfshirëse që ndërlidh të gjithë aspektet e reformës në arsim me vendosjen e fëmijës në qendër të vëmendjes në të gjitha veprimtaritë që organizohen dhe zbatohen në shkollë.

SHQK është një bashkëpunim mes aktorëve në komunitet, prindërve dhe shkollës, i fokusuar në:

- ▶ mbështetjen e zhvillimit të fëmijëve dhe të rinjve,
- ▶ përmirësimin e arritjeve të tyre,
- ▶ mbështetjen e familjeve,
- ▶ zhvillimin e komuniteteve.

SHQK synon zhvillimin cilësor të shkollës dhe aftësimin e fëmijëve dhe të rinjve si qytetarë të aftë për të kontribuar në komunitetet e tyre. Sistemi arsimor Shqiptar ka nevojë për shkollat komunitare, sepse fëmijët dhe të rinjtë kanë nevojë për më shumë mundësi dhe mbështetje që të kenë sukses në studimet dhe veprimtaritë e tyre brenda dhe jashtë orarit mësimor. SHQK mbështetet në moton e të punuarit së bashku për një qëllim të përbashkët.

Veçoritë e shkollës si qendër komunitare janë:

- ▶ SHQK konsiderohen ato institucione arsimore, të cilat i shërbejnë jo vetëm komunitetit shkollor (nxënës dhe mësues) por janë të hapura dhe në shërbim të gjithë anëtarëve të komunitetit.

- ▶ SHQK janë institucione të cilat ngrenë dhe zhvillojnë punën e tyre bazuar në nevojat e nxënësve, të familjeve dhe komunitetit;
- ▶ SHQK ofrojnë një sërë shërbimesh, pas orarit mësimor, për nxënësit, familjet dhe komunitetin;
- ▶ SHQK pranojnë prindërit si bashkëedukatorë dhe angazhojnë ata në vendimmarrje të përbashkëta;
- ▶ SHQK sigurojnë kohezionin social;
- ▶ SHQK ngrihen mbi pikat e forta të komunitetit.

Në SHQK, familja dhe komuniteti punojnë së bashku për të ndërtuar strategji të qëndrueshme për fëmijët, të rinjtë dhe familjet, për të pasuruar dhe nxitur përmes veprimtarive formale dhe jo formale dhe për të siguruar një mjedis që ofron dhe integron shërbime për shkollën, familjen dhe komunitetin. Elementi kyç i SHQK është i krijimi i bashkëpunimit dhe lidhja shumë e ngushtë e trinomit shkollë-familje-komunitet. Pjesëmarrja e nxënësve, prindërve, anëtarëve të komunitetit dhe strukturave lokale është thelbësore pasi siguron cilësi në edukim; vendimmarrje; ofrimin e strukturave shkollore efektive; transparencën në bashkëpunim; zhvillimin e vazhdueshëm të komunitetit; dhe zhvillimin e moduleve opsionale të bazuara në nevoja të komunitetit.

Standardet e SHQK janë një përmbledhje e karakteristikave më themelore që duhet të ketë një shkollë për të përmbushur misionin e saj si komunitare. Ato janë të

shprehura nëpërmjet 5 fushave dhe për secilën fushë jepen treguesit përkatës të cilët janë të matshëm. Fushat e standarteve të cilat janë dhe parimet bazë që udhëheqin shkollën si qendër komunitare janë:

1. Sigurimi i një arsimit cilësor për çdo nxënës.
2. Sigurimi i mirëqenies sociale, emocionale, shëndetësore të nxënësve.
3. Angazhimi dhe zhvillimi i komunitetit.
4. Vendimmarrja e përbashkët.
5. Respektimi i diversitetit.
6. Përdorimi i burimeve komunitare në shërbim të shkollës.

Përdoruesi i parë dhe më kryesor i standardeve është shkolla. Standardet i vijnë në ndihmë shkollës për:

- Të ndër marrë veprimtari për identifikimin e nevojave dhe përcaktimin e prioritetëve, për të mbështetur të nxënësit dhe nxënësve dhe përmirësuar arritjet e tyre.
- Të identifikojë pikat e forta dhe të dobëta, të cilat sigurojnë informacionin e nevojshëm për planifikimet strategjike.
- Të përcaktojnë fokusin e punës me partnerët dhe aktorët e tjerë.
- Të sigurojnë opinione të vazhdueshme nga nxënësit dhe familjet për të ndërtuar marrëdhënie të frytshme me ta.
- Të vlerësojnë dhe rishikojë cilësinë e marrëdhënieve me komunitetin.

## Veprimtari të shkollës si qendër komunitare

**1. Veprimtari për zhvillimin akademik të nxënësve** – Shkolla si qendër komunitare ofron programe dhe shërbime që sigurojnë mbështetje dhe zhvillim akademik për nxënësit dhe të rinjtë, duke plotësuar programin mësimor dhe duke i ardhur në ndihmë grupeve vunerabël në shkollë. Për të mbështetur zhvillimin akademik të nxënësve QN mund të organizojë në bashkëpunim me stafin pedagogjik konsultime lidhur me lëndët ose mund të nxis dhe të krijojë kurse/klube mbi përmbajtjen e lëndës që nxënësi po zhvillon në klasën e tij dhe thellojnë dijet në një fushë të caktuar kurrikulare apo dhe fushave të tjera kurrikulare.

**2. Veprimtari për zhvillimin artistik, kulturor dhe sportiv** – Shkolla si qendër komunitare mundëson që programet dhe shërbimet që ajo ofron t'i adresohen nevojave të zhvillimit fizik, mendor, emocional dhe social të nxënësve. Nxënësit gjejnë në shkollë informacionin dhe mjetet për përmbushjen e këtyre nevojave. Veprimtari që nxisin këtë aspekt të zhvillimit të nxënësve janë: veprimtaritë sportive si volejboll, basketboll, futboll, aerobi, etj; veprimtari kulturore si teatër, muzikë, kërcim, dramë, recitim, stilim, pikturë, etj. Këto veprimtari janë gjithëpërfshires dhe në to mund ta gjej veten çdo fëmijë apo i ri sipas interesave

dhe dëshirave të tij. Këto veprimtari mund të realizohen shumë mirë pas përfundimit të procesit mësimorë ku fëmijët dhe të rinjtë jo vetëm shkarkojnë lodhjen dhe energjitë e ditës por edhe kalojnë kohë së bashku dhe zhvillohen.

**3. Veprimtari për angazhimin dhe mbështetjen e familjes** – Shkolla si qendër komunitare I konsideron prindërit si partnerë dhe burim të rëndësishëm. Ajo krijon një klimë pozitive, mirëseardhje dhe bashkëpunimi, si dhe ndërton programe për përfshirjen e prindërve për të mbështetur fëmijët e tyre dhe shkollën si institucion, me qëllim rritjen e cilësisë së shërbimit në shkollë.

**4. Veprimtari për angazhimin e komunitetit** – Shkolla si qendër komunitare bashkëpunon ngushtë me komunitetin dhe mundëson programe, shërbime dhe mbështetje për anëtarët e komunitetit. Kjo shërben si burim për të nxënëit e komunitetit dhe shfrytëzimin e

burimeve të komunitetit për zhvillimin e fëmijëve, të rinjve dhe familjeve.

SHQK vendos në fokus: mbështetjen e zhvillimit të fëmijëve dhe të të rinjve; përmirësimin e arritjeve të tyre; mbështetjen e familjeve; dhe zhvillimin e komuniteteve. Dy shkolla si qendra komunitare nuk mund të jenë identike. Secila prej shkollave krijon profilin e saj në bazë të nevojave të identifikuara dhe burimeve të vlefshme në shkollë apo komunitet. Procesi i shndërrimit të shkollës në qendër komunitare është zhvillues. Aktorët që bashkëpunojnë zbulojnë gradualisht mundësitë që disponohen dhe rrisin përfitimet për nxënësit, familjet dhe komunitetin. Në shkollën si qendër komunitare mundësohet përfshirja e vazhdueshme dhe e përhershme e aktorëve. Nxitja e reflektimeve të vazhdueshme nga ata, do të ndihmojë në rritjen dhe përmirësimin e arritjeve të nxënësve dhe të shkollës.



## Vizioni për zhvillimin e plotë të shndërrimit të shkollave si qendra komunitare

### **Shkolla si qendër komunitare**

Shndërrimi i shkollave në vendin ku realizohet partneriteti shkollë, familje dhe komunitet duke shfrytëzuar të gjitha burimet që ofron shkolla, familja dhe komuniteti.



### **Rrjeti i shkollave komunitare**

Një rrjet i institucioneve arsimore, në një zonë të caktuar, të lidhur rreth një ose më shumë shkollave.



### **Komunitete ku shkolla shihet si partner**

Një komunitet që mbështet zhvillimin e të nxënësve të fëmijëve dhe të rinjve përmes bashkëpunimit të ngushtë me shkollat.

## Masa e ndërhyrjes për ngritjen e SHQK

- ▶ Ndërgjegjësim i gjithë aktorëve mbi qasjen e shkollës si qendër komunitare përmes bisedave, tryezave, debateve të hapura, botimeve etj.
- ▶ Përmirësimi i infrastrukturës shkollore për të mundësuar ofrimin e shërbimeve të larmishme.
- ▶ Vënia në dispozicion të shkollave e materialeve të domosdoshme për të mundësuar veprimtari të ndryshme të tematikave passhkollore.
- ▶ Ngritja e kapaciteteve të drejtuesve të shkollave, mësuesve, prindërve dhe përfaqësuesve në komunitet për bashkëpunim të efektshëm në veprimtarinë e shkollës.
- ▶ Fuqizimi i strukturave të shkollës, si bordi i shkollës, qeveria e nxënësve, këshillat e mësuesve etj, ku kanë rol aktiv prindërit dhe komuniteti.
- ▶ Hartimi dhe zbatimi i programe që mbështesin shkollat në eliminimin e fenomeneve si braktisja shkollore, dhuna në shkolla, zgjidhja e konflikteve, të drejtat e njeriut etj.
- ▶ Shkëmbimi i përvojave pozitive me institucione shkollore përtej vendit tonë.

## Partnerë potencialë të komunitetit mund të jenë:

- ↳ Biznesi (biznesi lokal, kompani të mëdha etj);
- ↳ Universitetet dhe institucione arsimore (shkolla publike dhe private, institucione të tjera arsimore etj);

- ↳ Organizata të kujdesit shëndetësor (spitale, qendra shëndetësore, organizata që punojnë për shëndetin);
- ↳ Institucione të qeverisjes (vendore), (qendrore – policia, zjarrfikësit, dhoma e tregtisë, institucione të tjera);
- ↳ Institucione kulturore (muze, biblioteka, galeri arti, teatër, etj);
- ↳ Organizata rinore
- ↳ Organizata me bazë vullnetare;
- ↳ Organizata të ndryshme sportive (klube sportive);
- ↳ Media (gazeta lokale, radio dhe televizioni lokal etj);
- ↳ Shërbime sociale;
- ↳ Individë nga komuniteti;

## Partnerë potencialë ne shkollë:

- ↳ Strukturat e shkollës
- ↳ Drejtoria e shkollës
- ↳ Stafi pedagogjik
- ↳ Shërbimi psikosocial

## Partnerë potencialë ne familje

- ↳ Prindërit
- ↳ Motrat dhe vëllezrit
- ↳ Kujdestarët
- ↳ Gjyshërit
- ↳ Të afërmit

Në procesin e ngritjes së shkollës si qendër komunitare hapi i parë dhe një nga hapat më të rëndësishme të këtij procesi është **vlerësimi i nevojave dhe burimeve**. Në këtë proces përfshihen të gjithë aktorët: nxënës, mësues, organizma dhe struktura të shkollës, komuniteti dhe familja. Vlerësimi i burimeve ndihmon shkollën të kuptojë atë

që është e vlefshme (apo e pavlefshme) në komunitetin e saj me qëllim që të adresojë kushtet dhe nevojat kritike. Informacioni i mbledhur mund t'i shërbejë shkollës për bashkëbisedimet me partnerë potencialë të komunitetit si dhe mbështet përpjekjet e shkollës për zhvillimin e burimeve që mungojnë në komunitet. Ky proces kalon përmes 2 etapave: **etapa 1:** Krijimi i një ekipi për vlerësimin e nevojave dhe burimeve. Në çdo shkollë funksionon një ekip koordinues i përbërë nga drejtori (ose nëndrejtori) i shkollës i cili është dhe drejtues i ekipit, anëtarë të bordit të prindërve, nxënës përfaqësues të qeverisë së nxënësve, mësues të shkollës, përfaqësues të pushtetit vendor si dhe përfaqësues të partnerëve të tjerë socialë. Ky ekip angazhon përfaqësues të tij ose ngre një ekip të posaçëm, i cili angazhohet në procesin e vlerësimit të nevojave dhe burimeve. **Etapa 2:** Zhvillimi i një plani vlerësimi dhe realizimi i tij. Hapi i dytë në procesin e vlerësimit të nevojave dhe burimeve është hartimi i një plani pune në të cilin detajohet mënyra si do të kryhet vlerësimi.

Pas vlerësimit të nevojave dhe të burimeve hapi i dytë i rëndësishëm është **hartimi i planit të shkollës si qendër komunitare**. Në këtë si hap hartohet një plan me të gjithë shërbimet që shkolla dhe partnerët mund të ofrojnë duke synuar përmirësimin e të nxënësve.

Ministria e Arsimit dhe Sportit çdo vit në udhëzimet përkates që nxjerr për fillimin e vitit akademik në një pikë të veçantë tërheq

vëmendjen për sa i përket të punuarit për krijimin dhe mbarëvajtjen e SHQK.

### 3.2 Roli i qeverisë së nxënësve në shkollat e kthyer në qendra komunitare



Në institucionet arsimore i jepet përparësi ngritjes dhe funksionimit sipas legjislacionit organizmave dhe strukturave të shkollës si: bordi i institucionit arsimor; qeveria e nxënësve; këshillat e prindërve të klasave etj.

Sipas Ligjit Nr. 69/2012 për Sistemin Arsimor Parauniversitar në Republikën e Shqipërisë, neni 36, pika 1 “QN është organizëm që mbron dhe promovon të drejtat e nxënësve dhe ndihmon në mbarëvajtjen e shkollës. Ajo ngrihet dhe funksionon sipas udhëzimit të ministrit.”

Qeveria e nxënësve në shkollë përfaqëson interesat e të gjithë nxënësve për të kontribuar në plotësimin e nevojave dhe zhvillimin e interesave të tyre duke synuar një shërbim arsimor sa më cilësor dhe një jetë sa më aktive të nxënësve. Kjo strukturë është “urë lidhëse” midis shkollës dhe



aktorëve të saj, familjes – komunitetit. Bazuar në rolin dhe funksionin e kësaj strukture është shumë e rëndësishme që kjo strukturë të marrë rol aktiv në gjithë jetën shkollore. Nëpërmjet kësaj strukture nxënësit (fëmijët dhe të rinjtë) përfshihen, bëhen pjesëmarrës dhe vendimarrës në jetën e shkollës dhe jashtë saj. Ata janë partnerë dhe pjesëmarrës aktivë në proceset e vendimmarrjes në shkollë dhe zgjidhjen e problemeve të ndryshme.

Aktualisht në të gjitha shkolla e AMU dhe AML janë ngritur Qeveritë e Nxënësve. Nga opinonet që japin nxënësit në AML kjo strukturë ka organizuar dhe është përfshire në zhvillimin e aktiviteteve dhe veprimtarive me tematika të ndryshme, në mbledhjen e fondeve për zgjidhjen e problematikave që lidhen kryesisht me jetën sociale si dhe në përmisimin e infrastrukturës. Gjithashtu struktura e QN ka organizuar fushata të ndryshme me qëllim sensibilizimin dhe advokimin për çështje që lidhen me të drejtat e fëmijëve. Disa QN kanë patur mundësi të organizojnë mbledhje të shkurtra me mësuesit e shkollës. Si një nga arritjet me të mëdha që QN e ka patur në disa nga shkollat nxënësit përmendim mbledhjen e fondeve për situata të ndryshme të krijuara si: për situatën e krijuar nga tërmeti, për familjet në nevojë apo për ndonjë ndërhyrje të vogël infrastrukture.

Një pjesë e nxënësve e kanë kuptuar mirë konceptimin e SHQK. Ata janë tepër aktivë dhe karakterizohen nga dëshira për të bërë gjëra (karakteristikë kjo e moshës së

adoleshencës). Shtysat apo faktorët që i nxisin këta nxënës, kryesisht burojnë së brendshmi nga dëshira e tyre për protagonizëm, lidhshmëri, për të marrë pjesë në aktivitete si edhe për të kontribuar. Por gjithmonë aktivitetet e tyre mbeten po në të njëjtën koriznë pa plotësuar kontributin e tyre të plotë në modelin e SHQK.

Bazuar në legjislacionin dhe në aktivitetet reale që kjo strukturë zhvillon në shkollë, shihet qartë se QN është aktive por jo me potencialin e saj të plotë. Në vëzhgimin e përditshëm dhe nga opinonet e disa nxënësve dallohet qartë që QN kanë përfshirje të ulët në hartimin e misionit të shkollës, në rishikimin e rregullave të shkollës, në bashkëpunimin e ngushtë me bordin e shkollës dhe stafin e mësuesve, në proceset e vendimmarrjes etj.

QN planifikon dhe realizon një gamë të gjerë veprimtarish, ndër të cilat:

- ✓ Veprimtari për vlerësimin e nevojave të komunitetit të nxënësve.
- ✓ Veprimtari që nxitin një komunikim më të mirë brenda në shkollë
- ✓ Veprimtari për të ndihmuar nxënësit e tjerë për përparimin e tyre.
- ✓ Veprimtari që ndihmojnë mbarëvajtjen e shkollës.
- ✓ Veprimtari që lidhen me ngjarje shkollore sportive dhe kulturore.
- ✓ Veprimtari që lidhen me ndihmesën ose me organizimin e përfimit të fondeve për bamirësi.

- ✓ Veprimtari që sigurojnë komunikimin me qeveritë e nxënësve të shkollave të tjera.

Disa nga aktivitetet që mund të zhvillohen në shkollë nga QN me pjesëmarrje dhe të nxënësve të shkollës janë:



- Pjesëmarrje aktive në takimet e Bordit të shkollës dhe të stafit akademik.
- Trajnime për rritje të kapaciteteve të vetë strukturës së QN dhe trajnime të nxënësve me tema të ndryshme.
- QN në bashkëpunim me aktorë të tjerë organizon takime ose aktivitete sensibilizuese me bazë shkolle për të gjithë nxënësit me qëllim shpjegimin e rolit dhe funksionit të kësaj strukture, vlerat dhe rëndësinë që ka kjo strukturë për nxënësit.
- Veprimtari që kanë të bëjnë me mbledhjen e informacionit nga nxënësit (me anë të bisedave, vëzhgimeve, pyetësorëve etj.) ashtu edhe veprimtari që kanë të bëjnë me paraqitjen e informacionit të drejtuesit të shkollës ose organet kolegjiale dhe diskutimin me ta.
- QN jep kontributin e saj duke propozuar metoda konkrete në funksion të përparimit të nxënësve.
- QN mund të japë ndihmesë në mënyrë aktive në mbarëvajtjen e shkollës duke formuar grupe të përkohshme pune me nxënës për një çështje të posaçme (përshembull: për disiplinën, për mjedisin etj.) dhe të paraqesë te drejtuesit propozime konkrete.
- QN mund të propozojë edhe veprimtari jashtë kurrikulare (përshembull: organizimin e konkurseve).
- QN mund të ndihmojë në organizimin dhe zhvillimin e sporteve dhe aktiviteteve kulturore në shkollë.
- QN mund të organizojë veprimtari si brenda shkollës dhe jashtë shkollës (përshembull: sensibilizimin për një problem që kërkon fonde, shfaqje artistike) me përfshirjen e komunitetit më të gjerë, me qëllim përfundimin e fondeve për bamirësi të caktuara.
- Krijimi i një rrjeti të shkollave si qendra komunitare dhe shkëmbimi i përvojave midis tyre kërkon dhe mundëson që QN të një shkolle të bashkëpunojë me Qeveritë e Nxënësve të shkollave të tjera (përshembull: veprimtari të përbashkëta artistike, sportive, projekte të përbashkëta).
- Për realizimin e planeve të saj, QN mund të ndërtojë ura komunikimi e bashkëpunimi me të gjitha organet drejtuese të arsimit në shkollë e më

- gjerë dhe strukturat kolegjiale të shkollës.
- QN bashkëpunon për probleme e projekte të caktuara me organizata jashtë shkollës, të cilat kanë në fokus të punës së tyre të drejtat e njeriut dhe marrëdhënieve reciproke në përputhje me rregulloren e shkollës dhe rregulloren e qeverisë së nxënësve ku janë të përcaktuara detyrat dhe të drejtat e secilit.
  - QN nxit nxënësit të lexojnë disa libra dhe më pas organizon orë të hapura me pjesëmarrjen e mësuesve të shkollës dhe prindërve për një nga librat.
  - QN boton gazetën e shkollës me disa rubrika të sugjeruara nga nxënësit.
  - “Spelling Be”- Aktiviteti i Garës së Germëzimit mund të organizohet me nxënësit që mësojnë gjuhën angleze. Ka nisur të praktikohet në Shtetet e Bashkuara të Amerikës por ka filluar zbatim edhe në Shqipëri. QN së bashku me mësuesin e ndihmës dhe mësuesin e anglishtes mund të organizojnë aktivitetin.
  - Kutia e Ankesave dhe Sugjerimeve – QN krijon 2 kuti dhe i vendos në shkollë. Njofton të gjithë nxënësit e shkollës që mund të dërgojnë mendimet e tyre, ankesa dhe sugjerime pa shënuar emrin. Kjo i jep mundësi çdo nxënësi të shprehë mendimin e tij.
  - Konkurs për “Konventën mbi të drejtat e Femijëve”- Konkursi bazohet jo tek njohuria që kanë nxënësit mbi të drejtat por tek zbatimi i të drejtave nga njëri tjetri. Ky aktivitet rrit tolerance dhe nxit bashkëpunimin. QN organizon edhe konkurse me tematika të ndryshme.
  - Teatri i shkollës – Mund të organizohet një konkurs me pjesë teatrale nga çdo klasë. Ftohen prindërit të ndjekin teatrin duke blerë bileta. Klasa që ka mbledhur më shumë të ardhura do të ketë automatikisht 5 pikë më shumë.
  - Histori përmes vizatimit/ pikturës - Nxënësit angazhohen në tregimin e një historie përmes vizatimit.
  - Festimi i karnavaleve – Pjesëmarrje në parada të karnavale në qytet, ose mund ta ktheni në traditë në zonën tuaj si aktivitet.
  - Panairi i ushqimit - Nxënësit angazhojnë prindërit, mësuesit dhe vetë të gatujnë ushqime tradicionale nga vendlindja e tyre.
  - Panair punimesh me dorë – Punime të nxënësve dhe prindërve me grip, shtiza apo edhe sende të riciklueshme.
  - Unë Mbroj Pemët - Punime të nxënësve me riciklimin e materialeve shkollore, librave, fletoreve etj.
  - Mbill një lule- QN inkurajon nxënësit të sjellin një lule në shkollë dhe ta vendosin në ambjentin përreth saj.
- Në të gjitha këto aktivitete e të tjera si këto QN mund të bëjë pjesë të saj jo vetëm strukturat e tjera të shkollës, bordin e shkollës dhe stafin pedagogjik, por edhe anëtarë të komunitetit dhe të profesioneve të ndryshme që i vijnë në ndihmë shkollës

### 3.3 Aksesi dhe menaxhimi i shkollës mbas përfundimit të mësimit, krijimi i klubeve të nxënësve pjesë e qendrave komunitare

Në kuadër të nismës "Shkolla si qendër komunitare, një shkollë miqësore për të gjithë" shkollat duhet të parashikojnë veprimtari të zbatueshme në përshtatje me profilin e tyre, në bazë të nevojave të komunitetit, duke përbushur këto objektiva:

- ▶ Të sigurojë hapjen e saj përtej orarit mësimor, duke realizuar aktivitete që mundësojnë rritjen e cilësisë në arsim;
- ▶ Shkolla të ofrojë shërbime që sigurojnë mirëqenie sociale, fizike, emocionale dhe shëndetësore për të gjithë;
- ▶ Të mundësojë angazhimin dhe zhvillimin socio-ekonomik të komunitetit si dhe shërbimeve mbështetëse ndaj familjarëve;
- ▶ Të jetë bashkëpunuese dhe inicuese duke mundësuar pjesëmarrjen aktive të aktoreve në vendimmarrje;

Një mënyrë se si QN mund të përbushë detyrimin e saj për angazhimin e nxënësve, është duke përdorur hapësirat dhe mundësitë që ofron shkolla si qendër komunitare. Angazhimi dhe pjesëmarrja e nxënësve shkon përtej përfundimit të procesit mësimor nëpërmjet promovimit të hapësirave, ambienteve dhe mundësive të tjera që ofron mjedisi i shkollës. Shkolla vë në dispozicion mjediset dhe hapësirat e saj për takime sociale periodike dhe ekspozim

e diskutim të çështjeve të ndryshme me interes për nxënësit, të rinjtë, stafin dhe partnerët. QN duhet të ketë në planet e saj aktivitete jashtëshkollore për nxënësit dhe të rinjtë për të mësuar dhe argëtuar duke përfutur nga të gjitha mundësitë e mundshme. Këto aktivitete dhe veprimtari të zhvilluara në hapësira ose mjedise të shkollës duhet të shihen si një 'përforsim kritik' i procesit të të mësuarit, ndërsa zgjerojnë mundësi për të ndërtuar dhe të forcuar aftësitë e reja tek nxënësit dhe të rinjtë.

Të gjitha aktivitetet jashtëshkollore mund të klasifikohen sipas qëllimeve që arrihet gjatë zbatimit të tyre. Pra, ekzistojnë tre lloje të veprimtarive jashtëshkollore në shkollë:

- ▶ Mësimdhënies dhe arsimit; Mësimdhënia e veprimtarive jashtëkurrikulare ka për qëllim forcimin e veprimtarisë njohëse të nxënësve, zgjerimin e rrethit të interesave të tyre, thellimin e njohurive, ndërtimin e një pozicioni qytetar.
- ▶ Aktivitete të kohës së lirë; Lloji i kohës së lirë të aktiviteteve jashtëshkollore ka për qëllim marrjen nga nxënësit, të rinjtë të aftësive të reja, nevoja për të cilën lind jashtë aktiviteteve tradicionale arsimore. Ngjarjet argëtuese ndihmojnë në diversitetin e jetës së përditshme të shkollës dhe jashtë saj.
- ▶ Sportive dhe palestër; Aktivitetet jashtëshkollore sportive kontribuojnë në zhvillimin fizik dhe forcimin e shëndetit të nxënësve të shkollës,

nxitjen e konkurrencës së shëndetshme dhe ambiciet personale, dhe mëson ndërveprimin me të tjerë.

Udhëzimi i Ministrisë së Arsimit dhe Sportit, kërkon që QN të marrë pëlqimin e drejtorit të institucionit për çdo bashkëpunim që mund të realizojë me organizata të ndryshme që kanë në fokus të drejtat e të rinjve. QN dhe organizatat jo-fitimprurëse janë një mënyrë e mirë për të angazhuar të rinjtë në aktivitete dhe klube, ndërkohë që përdoren me efikasitet burimet e shkollës dhe komunitetit.

Klubet e nxënësve janë grupime të bazuara në iniciativa dhe aktivitete të nxënësve që kanë për qëllim krijimin, organizimin dhe vazhdimësinë e disa veprimtarive specifike në fushën e shërbimeve ndaj dhe për komunitetin, organizimin dhe vazhdimësinë e aktiviteteve specifike, rritjes dhe zhvillimit të karrierës, vullnetarizmit, sporteve, mjedisit etj. Klubet janë të llojeve të ndryshme brenda një shkolle, por ato ndajnë së bashku: vlerat, misionin dhe filozofinë e shkollës.

### Disa klube që mund të krijohen nga QN janë:

- ▶ Klubet e sipas lëndëve janë klube që vijnë nga interesi për një fushë lëndore të mësuar në shkollë. Kategori të klubeve të fushave lëndore: Arti, Fiskultura, Shkenca, Matematika, Letërsia, Historia dhe Gjuha.
- ▶ Klubet hobi janë klube që rrjedhin nga interesi për një hobi që ka shumë të ngjarë që nuk do të mësohet në shkollë

(të tilla si shah, anime, video lojëra dhe kërcim).

- ▶ Klubet e bamirësisë janë klube që janë të lidhura me një bamirësi specifike me qëllim të ngritjes së vetëdijes, duke punuar për atë bamirësi, ose mbledhjen e parave për atë bamirësi (të tilla si fushata sensibilizimi, pastrim, dhe ndihmë ndaj komunitetit).

Klubet e nxënësve sigurojnë një pjesëmarrje aktive në vendimarrjen në shkollë dhe forcojnë më shumë trekëndëshin nxënës-mësues-komunitet.

Mundësi të tjera përfshijnë aktivitete krijuese, gazetari (shtypi dhe radio), tutorizimi i shkollës, klubet e debatit, edukimi shëndetësor, aftësimi për punë dhe aktivitete me dhe për komunitetin. Këto aktivitete shpesh ndërmerren pas shkollës, gjatë periudhave të pushimeve ose si pjesë e nismave të fundjavës dhe mund të zgjerojnë idenë e hapësirave mësimore miqësore ndaj fëmijëve.

Aktivitetet jashtëshkollore janë një mënyrë e shkëlqyeshme që nxënësit të marrin pjesë në një mjedis të sigurtë dhe produktiv pasi të ketë mbaruar shkolla. Kur zilja bie, nuk do të thotë që dita e fëmijës tuaj ka mbaruar. Kjo kohë pas shkollës duhet të jetë e mbushur me mundësi të bollshme për që nxënësit dhe të rinjtë të vazhdojnë zhvillimin e tyre. Përfshirja në aktivitete tregohet fëmijët dhe të rinjtë janë përgjithësisht më të lumtur dhe më të shëndetshëm kur janë të angazhuar në gjëra që pëlqejnë të bëjnë.

## PRAKTIKA TË MIRA NGA VENDET E RAJONIT DHE BOTËS

Qeveritë e nxënësve, qëllimi kryesor i të cilave është të përfaqësojnë dhe mbrojnë interesat e nxënësve të shkollës, janë pjesëmarrës thelbësorë në qeverisjen evropiane në arsim.

### Struktura e qeverisë së nxënësve në Spanjë



Në shkollat e mesme në Spanjë, Qeveritë e Nxënësve synojnë të përfaqësojnë dëshirat dhe nevojat shoqërore dhe akademike të trupit studentor. Qeveria e Nxënësve ndihmon për të promovuar frymën dhe unitetin e shkollës dhe gjithashtu ka si qëllim prodhimin e udhëheqësve me potencial për të fituar aftësitë e udhëheqjes.

Në Spanjë, përfaqësuesit e zgjedhur nga secila klasë takohen çdo javë dhe janë të përfshirë në aktivitete për mbledhjen e fondeve, këshillojnë për rregulloret e shkollës dhe organizimin e ngjarjeve sociale që forcojnë punën në ekip, udhëheqjen dhe vullnetarizmin. Qëllimet e Qeverisë së Nxënësve, janë të krijojnë një mjedis të rehatshëm me komunikim



dhe mirëkuptim të qartë midis nxënësve, dhe të formojnë një mjedis në të cilin të gjithë nxënësit e kuptojnë, respektojnë dhe vlerësojnë diversitetin kulturor të njëri-tjetrit. Pjesëmarrja e nxënësve kanalizohet përmes përfaqësuesve të tyre, përkatësisht: delegatëve të klasës, bordit të delegatëve dhe shoqatës së nxënësve/qeverisë së nxënësve.

1. Delegatët e klasës zgjidhen me votim të drejtpërdrejtë dhe të fshehtë, nga radhët e nxënësve të secilës klasë. Delegatët janë përgjegjës për të kontribuar në krijimin e një klime pozitive në klasat e tyre. Ata duhet të përfaqësojnë klasën para mësuesve të tyre ose pjesës tjetër të autoriteteve arsimore. Ata gjithashtu duhet të vëzhgojnë përdorimin e duhur të materialeve shkollore dhe lehtësirat, dhe të marrin përgjegjësi të tjera që u janë caktuar në Rregulloren e Shkollës.
2. Bordi i delegatëve, i cili gjendet vetëm në shkollat e mesme, përbëhet nga delegatë të ndryshëm të secilit klasë.
3. Qeveria e nxënësve është përgjegjëse, për të shprehur mendimet e nxënësve, për informimin e tyre për çështjet shkollore dhe kanalizimin e pjesëmarrjes së tyre në organet e ndryshme të institucionit. Qeveria e nxënësve është gjithashtu përgjegjëse për organizimin e veprimtarive kulturore dhe sportive, për nxitjen e bashkëpunimit në shkollë dhe për të ndihmuar nxënësit në ushtrimin e të drejtave të tyre.

### Këshilli Kombëtar i Studentëve (NatStuCo)



Në Reston, Virxhinia, ekziston një strukturë e quajtur Këshilli Kombëtar i Studentëve (NatStuCo), e cila bashkon qeveritë e nxënësve nga i gjithë vendi për të shkëmbyer përvoja, praktikat më të mira dhe ekspertizën. Që nga viti 1931, qëllimi i Këshillit Kombëtar Studentor (NatStuCo) ka qenë të ndihmojë të gjithë qeveritë e nxënësve të bëhen më efektive. NatStuCo përfaqëson qeveritë e nxënësve të shkollave të mesme në mbarë vendin. Ai synon të sigurojë një partneritet të vlefshëm drejtimi midis nxënësve dhe shkollës së tyre. Krijon mundësinë që nxënësit të bëhen udhëheqës efektivë, duke inkurajuar dhe ndikuar në një klimë pozitive shkollore. NatStuCo është një program i Shoqatës Kombëtare të Drejtorëve të Shkollave të Mesme (NASSP) në Reston, Virginia.

NatStuCo ka të bëjë me:

- ▶ Udhëheqjen - Mbështetja dhe zhvillimi i aftësive dhe njohurive të udhëheqjes së nxënësve.
- ▶ Shërbimin - Ndhma për të krijuar një klimë të kujdesit dhe tolerancës përmes vullnetarizmit dhe shërbimit ndaj të tjerëve.
- ▶ Zërin e Nxënësit - Promovimi i qeverisë së nxënësve si zëri i nxënësve dhe dhënia e mundësisë së çdo nxënësi për t'u dëgjuar.
- ▶ Angazhimin - Inkurajimi i nxënësve që të përfshihen në udhëheqjen e shkollës dhe komunitetit dhe vendimarrjen.

Vizioni i NatStuCo është promovimi dhe ofrimi i mundësisë për zhvillimin e lidershit për të përgatitur dhe fuqizuar qeveritë e nxënësve për t'u shërbyer shkollave dhe komuniteteve të tyre.

Qëllimet e NatStuCo:

1. Të mbështesë qeverinë e nxënësve si një organizatë jetike brenda shkollës dhe komunitetit të saj.
2. T'u sigurojë anëtarëve të qeverisë së nxënësve burime dhe mbështetje në të gjitha fazat e aktiviteteve.
3. Të ndihmojë të gjitha qeveritë e nxënësve për t'u bërë më efektive brenda shkollës, komunitetit, shtetit dhe kombit të tyre.
4. Sigurimi i trajnimit për udhëheqje për anëtarët e qeverisë së nxënësve.
5. Të inkurajojë zhvillimin e qeverive të reja nxënësish në shkollat e mesme.



## Byroja Organizative e Shoqatave Studentore të Shkollave Europiane (OBESSU)



Byroja Organizative e Shoqatave Studentore të Shkollave Europiane (OBESSU) është platforma për bashkëpunim midis unioneve të nxënësve të shkollave kombëtare që janë aktive në arsimin e mesëm të përgjithshëm dhe atë profesional në Europë. Ajo u themelua në prill 1975 në Dublin, Irlandë dhe bashkon organizatat anëtare, kandidate dhe bashkëpunëtorë nga e gjithë Europa. Të gjitha organizatat anëtare janë organizata të pavarura, kombëtare, përfaqësuese dhe demokratike të shkollave.

OBESSU ka si qëllim:

- të përfaqësojë nxënësit e shkollave si palë të interesuara të sistemeve të tyre arsimore dhe në çështjet që kanë të bëjnë me jetën e tyre;
- t'u sigurojë unioneve të nxënësve të shkollave kombëtare, ndihmë dhe mbështetje dhe të bashkëpunojë për zhvillimin e strukturave përfaqësuese të nxënësve të shkollës;
- të inkurajojë dhe mundësojë shkëmbimin e përvojave dhe praktikave të mira midis unioneve të nxënësve të shkollave kombëtare;
- të promovojë qasje të barabartë në arsim dhe të përpiqet për t'i dhënë fund të gjitha diskriminimeve dhe padrejtësive brenda sistemeve arsimore;
- të kontribuojë në zhvillimin e sistemeve arsimore demokratike në Europë, që promovojnë qytetarinë aktive në të gjitha format;
- të promovojë solidaritetin dhe mirëkuptimin midis të rinjve;

## Bibliografia

- Das, A., Kumar Singh, A., & Krishna, G. (2011). *Study of structure of student council in colleges and universities and associated motivation and job satisfaction factors.*
- Democracy in school. (2015). In *Teaching Civics - A Manual for Secondary Education Teachers*. Opladen , Berlin, Toronto: Verlag Barbara Budrich .
- LIGJI Nr. 69/2012 “PËR SISTEMIN ARSIMOR PARAUNIVERSITAR NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË”. (n.d.).
- Markja, A., Mastori, E., & Sina , I. (2014). SHKOLLA QENDËR KOMUNITARE - UDHËZUES PËR MËSUESIN. In *SHKOLLA QENDËR KOMUNITARE - UDHËZUES PËR MËSUESIN*. Tiranë.
- National Student Council*. (n.d.). From National Student Council:  
<https://www.natstuco.org/>  
(2002 ).
- Student councils: a voice for students*. Department of Education and Science.
- Student Government in High School & College Boost Your Resume While Making a Difference*. (n.d.). From ACCREDITED SCHOOLS ONLINE: EDUCATION ON YOUR TIME: <https://www.accreditedschoolsonline.org/resources/student-government/>
- The Organising Bureau of European School Student Unions* . (2020). From The Organising Bureau of European School Student Unions : <https://www.obessu.org/>

Për më tepër informacion:

- Facebook: <https://www.facebook.com/kongresirinor/>
- Instagram: [https://www.instagram.com/kongresi\\_rinor\\_kombetar/?hl=en](https://www.instagram.com/kongresi_rinor_kombetar/?hl=en)
- LinkedIn: <https://www.linkedin.com/company/national-youth-congress-of-albania>
- Twitter: [https://twitter.com/nyc\\_albania](https://twitter.com/nyc_albania)

